



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glllogocit
Zyra e Kryetarit



01-Nr 400-3165 dt. 17/01 2020

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 dhe nenit 20 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.05/2014 për pjesëmarrjen e publikut në Planifikimin Hapësinor, neni 4 paragrafi 3 pika 3.1, neni 7 paragrafi 2 dhe 3, nenit 8, 10, 12 dhe 14, sipas Vendimit Nr.6225-2/19 të datës 16.01.2020 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe në bazë të nenit 58 pika (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72 paragrafi 1 pika (h) të Statutit të Komunës së Glllogocit, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës, të miratoj këtë:

PROPOZIM VENDIM
PËR SHQYRTIMIN PUBLIK TË PROJEKT-PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL
TË GLLOGOCIT PËR PERIU DHËN 2020-2028

Neni 1

Kuvendi i Komunës së Glllogocit të miratoj propozim vendimin për shpalljen në shqyrtimin publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit për periudhën 2020-2028.

Neni 2

2.1 Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi i Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028 bëhet në sallën e Kuvendit Komunal.

2.2 Shqyrtimi publik i Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Glllogocit 2020-2028 zgjat 30 ditë, sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

2.3 Shpallja e shqyrtimit publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028 bëhet tetë ditë para hapjes së tij përmes mjeteve të informimit publik, përkatësisht ueb faqës së Komunës.

Neni 3

3.1 Në shqyrtimin publik prezantohet pjesa tekstuale dhe grafike e Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028.

P. 21

3.2 Në shqyrtimin publik prezantohen fazat e Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028: Korniza Strategjike, Profili i Komunës, vlerësimi i gjendjes, vizioni, qëllimet dhe objektivat, koncepti i zhvillimit hapësinor dhe Plani i veprimit.

3.3 Projekt- Plani Zhvillimor Komunal i Glllogocit 2020-2028 është i qasshëm, për publikun në formë të shtypur dhe elektronike.

Neni 4

4.1 Projekt-Plani Zhvillimor Komunal i Glllogocit 2020-2028 u nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të publikut para se të finalizohet.

4.2 Të gjitha vërejtjet, komentet dhe sugjerimet që paraqiten nga publiku gjatë diskutimeve, me shkrim, në librin e vërejtjeve apo përmes adresës elektronike, brenda afatit kohor të përcaktuar, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

Neni 5

Shqyrtimi publik i Projekt-Plani Zhvillimor Komunal i Glllogocit 2020-2028 organizohet nga Komuna në kuadër të kompetencave ligjore.

Neni 6

6.1 Me këtë propozim vendim parashihen sigurimi i kushteve teknike dhe financiare që nevojiten gjatë kohës së shqyrtimit publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028.

6.2 Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi do të jetë edhe plani i organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së shqyrtimit publik (prezantimi i PZHK-së, njoftimi i qytetarëve, sigurimi i materialit elektronik dhe fizik i PZHK-së dhe veprimet tjera për të siguruar një qasje normale të qytetarëve në Planin Zhvillimor Komunal).

Neni 7

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 8

Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Glllogocit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

Kryetari i Komunës
Rafiz Lladrovci



ARSYETIM

Bazuar në obligimet ligjore që përcaktohen në Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Komuna e Glllogocit ka filluar me procesin e hartimit të Planit Zhvillimor të Komunës.

Procesi i hartimit të PZHK-së ka filluar me vendimin për hartimin e PZHK-së marrë nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit me datë 31.01.2018, në të cilën bartës i procesit të hartimit të PZHK-së është përcaktuar Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.


Për të udhëhequr procesin e planifikimit në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse, komuna ka themeluar dy mekanizma:

- Ekipin Komunal për Planifikim (EKP) - të përbërë nga të gjitha drejtoritë e komunës së Glllogocit (Drenasit). Ekipi Komunal i Planifikimit ka shërbyer si platformë për të mbledhë informata nga të gjitha drejtoritë dhe kompanitë publike në komunë, si dhe për të dhënë kontribut në përmbajtjen e PZHK-së në të gjitha fazat e hartimit të tij. Për më shumë EKP ka shërbyer për të harmonizuar kërkesat dhe projektet të të gjithë sektorëve në komunë.
- Ekipin Këshillues të Komunitetit (EKK) – të përbërë nga të gjitha komunitetet në komunën e Glllogocit (Drenasit). Anëtarët e EKK-së janë përfaqësues të shoqërisë civile, të rinjëve, grave, të moshuarve, personave më aftësi të veçanta, bizneseve, komuniteteve fetare dhe kryetarë të bashkësive lokale. EKK ka shërbyer si urë lidhëse në mes të komunës dhe qytetarëve të komunës. Detyrë primare e EKK-së ka qenë komunikimi me qytetarë rreth përmbajtjes së PZHK-së në faza të ndryshme të hartimit.

Procesi i hartimit të PZHK-së ka kaluar në katër faza kryesore siç janë: profili, vlerësimi i gjendjes ekzistuese, koncepti i zhvillimit hapësinor, dhe prioritetet strategjike me planin e veprimit. Të gjitha fazat janë përcjellur me pjesëmarrje aktive të qytetarëve dhe akterëve tjerë relevant dhe me mbajtjen e punëtorive për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028.

Për të vazhduar me procedura të mëtutjeshme për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal për periudhën kohore 2020-2028, bazuar dhe në nenin 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 dhe nenit 20 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.05/2014 për pjesëmarrjen e publikut në Planifikimin Hapësinor, neni 4 paragrafi 3 pika 3.1, neni 7 paragrafi 2 dhe 3, nenit 8, 10, 12, përcaktohet se, duhet të miratohet propozim vendimi për shpalljen në shqyrtimin publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit në të cilën u nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të publikut para se të finalizohet ngase përfshihen objektivat kyqe që parashohin zhvillimin e komunës për tetë vitet e ardhshme.

R. U



REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVES
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPESINOR
MINISTRIE DHE PLANIFIKIMIT HAPESINOR
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

№ i Gj. 02. 02. 2020
Data 14.01.2020
Peshë 1.0

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

DATE/A:	16.01.2020
REFERENC-Ë:	ZSP - 23/2020
PËR/ZA/TO:	Flutura Avdiu, Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrotje të Mjedisit, Komuna e Glllogocit
CC:	Ramiz Lladrovci, Kryetarit të Komunës së Glllogocit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim për marrjen e Vendimit për hapjen e shqyrtimit publik të Projekt- "Planin Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2019-2027"

E nderuara znj. Avdiu,

Bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor nen 11 paragrafi 1.9 dhe nënparagrafi 1.9.1, Komuna e Glllogocit ka dorëzuar Projekt "Planin Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2019-2027" në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me datë 16.12.2019 me numër të protokollit 6225-2/19 për të verifikuar përputhshmërinë me "Planin Hapësinor të Kosovës -Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+" para shqyrtimit publik, si dhe me nenin 9 paragrafit 2 nën paragrafit 2.3, me të cilën Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për vlerësimin e përputhshmërisë së Projekt Planin Zhvillimor të Komunës. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor pas shqyrtimit dhe verifikimit të Planit Zhvillimor të Komunës që është në përputhje me "Planin Hapësinor të Kosovës - Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+" dhe duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPALITY			
Prantuar	20 / 01 /		2020
Nj. Org.	Numar	Shifra	Vlera
01	030101	3439	

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË
KOMUNËS DHE QEVERISË
KOMUNALE PËR VITIN 2020



DRENAS
Janar, 2020

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

Përmbajtja

1.	PARIMET E QEVERISJES SË KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE	2
2.	PRIORITETET E PËRCAKTUARA NË FILLIM TË MANDATIT	2
3.	PLANIFIKIMET SIPAS ZYRAVE	3
3.1.	Zyra për Integritet Evropian	3
3.2.	Zyra për Komunikim me Publikun	4
3.3.	Zyra Komonale për Komunitete dhe Kthim	5
3.4.	Zyra e Burimeve Njerëzore	8
3.5.	Zyra e Auditorit të Brendshëm	8
3.6.	Zyra e Avokatit Komunal	16
4.	PLANIFIKIMET SIPAS DREJTORIVE	17
4.1.	ADMINISTRATA DHE PERSONELI	17
4.2.	DREJTORIA E ARSIMIT	25
4.3.	DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	27
4.4.	DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL	32
4.5.	DREJTORIA E INSPEKSIONIT	35
4.6.	DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA	38
4.7.	DREJTORIA PËR SHËNDETËSI E MIRËQENIE SOCIALE	40
4.8.	DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT	56
4.9.	DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË	57
4.10.	DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË	59
4.11.	DREJTORIA PËR INFRASTRUKTURË PUBLIKE	69
4.12.	DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK	71

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

Punësimi në institucionet e Komunës do të bëhet me mbikëqyrjen e Organizatave Joqeveritare, në mënyrë që punësimi të bëhet me merita dhe me kualifikimin e duhur.

3. PLANIFIKIMET SIPAS ZYRAVE

3.1. Zyra për Integrime Evropiane

Detyrat e punës

1. Të gjitha aktivitetet duhet të jenë në harmoni me Rregulloren e Qeverisë nr. 08/2011, planin dhe programin e punës që rrjedhin nga implementimi i Planit të Veprimit i Marrëveshjes për Stabilizim-Asocimit (PVMSA) në pajtim me Ligjet, Rregulloret dhe aktet tjera të organeve të pushtetit qendror dhe lokal që kanë të bëjnë edhe me procesin e standardëve të Integrimit të Bashkimit Evropian ;
2. Koordinimin e aktiviteteve me Kryetarin e Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive në Komunë në implementimin e obligimeve që rrjedhin nga PKVMSA-ja dhe aktivitete tjera në funksion të procesit të integrimeve evropiane;
3. Bashkërendimin e veprimtarive me gjithë zyrtarët komunal për zbatimin e PKVMSA-së dhe merr pjesë në këto grupe punuese;
4. Koordinimin me të gjitha organizatat qeveritare dhe jo qeveritare të cilat ofrojnë asistencë –përkrahje në implementimin e PKVMSA-së dhe merr pjesë në këto grupe punuese ;
5. Përgatitja e planeve të veprimit në baza 6 mujore lidhur me veprimet që janë ndërmarrë në implementimin e PKVMSA-së ;
6. Përgatit raporte të punës 6 mujore dhe vjetore lidhur me veprimet që janë ndërmarrë në implementimin e PKVMSA-së ;
7. Mbajtjen e rregullt të shënimeve dhe përkujdesjen për dokumentacionin që ka të bëjë me veprimet lidhur me implementimin e PKVMSA-së ;
8. Organizimi i aktiviteteve promovuese për PKVMSA-në në kuadër të Komunës në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar me veprimet që kanë të bëjnë me veprimet lidhur me implementimin e integrimeve evropiane ;
9. Merr pjesë në takime dhe trajnime në MAPL, MIE dhe Ministri e institucione të tjera që kanë të bëjnë me integrime evropiane, merr pjesë në Kolegjiumin e ZKIE të Asociacionit të Komunave të Kosovës me Zyrtarët tjerë komunalë për Integrime Evropiane.

Të priturat : organizim dhe bashkëpunim me Kryetarin e Komunës dhe Drejtorët e drejtorive për realizimin e obligimeve të komunave të cilat dalin nga agjenda evropiane dhe zbatimi i legjislacionit në fuqi lidhur me këto obligime.

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

3.3. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Qëllimi 1: Organizimi i brendshëm i ZKKK-së

<i>Qëllimi veprues</i>	<i>Aktiviteti</i>	<i>Indikatorët matës</i>	<i>Risku dhe Supozimi</i>	<i>Afati kohor</i>
1. Buxheti për vitin 2020-2021 i hartuar dhe i aprovuar (Rregullorja e qeveris për ZKKK-të 02/2010, neni 10.1)	Në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës ZKKK do të avokojë për buxhet të mjaftueshëm për 2020. Udhëheqësi i zyrës në bashkëpunim me zyrtarin për financa do të hartoj buxhetin për vitin 2020.	Aprovuar buxheti për 2020. Arrihet marrëveshje me shkrim për buxhetin 2020. Hartohet buxheti për 2020 dhe dorëzohet.	Mungesa e burimeve financiare për 2020 Mungesë bashkëpunimi me zyrtarin për buxhet dhe financa.	Dhjetor 2020-Shkurt 2021 për buxhetin e vitit 2020 Dorëzohet buxheti për 2020 në Gusht të 2019.

Qëllimi 2: Bashkëpunimi me organet komunale dhe qeveritare, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare

<i>Qëllimi veprues</i>	<i>Aktiviteti</i>	<i>Indikatorët matës</i>	<i>Risku dhe Supozimi</i>	<i>Afati kohor</i>
1. Pjesëmarrja e rregullt në takimet që mbahen në Komunë (Rregullorja e qeverisë për ZKKK-të 02/2010, neni 7.1.7)	Merr planin vjetor të takimeve të asamblesë komunale. Merr planin vjetor të takimeve të KK-së, ose mban takime të rregullta me kryesuesin e komitetit. Mban lidhje të ngushta me zyrën pritëse të kryetarit që të informohet për takimin e bordit të drejtorëve. Krijon kalendarin e aktiviteteve të zyrës.	Pjesëmarrje aktive. Numri i takimeve. Shkruhet raport për aktivitetet.	Mungesë bashkëpunimi nga kryesuesit e Asamblesë Komunale dhe Komitetit për Komunitete Nuk ka takime të rregullta të bordit të drejtorëve. Nuk ftohem në mbledhje të bordit	Në baza të rregullta.

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

Riintegrimi çështje me rëndësi të veçante, në bashkëpunim me MPB, MPMS, MKK, MMPH, MAPL Projekti me GIZ	Këshillimi i personave të riatdhesuar Regjistrimi civil Qasje në Punësim, Arsimit Shëndetësi, mirëqenie sociale dhe dikastere të tjerë. Ngritja profesionale për vetëpunësim (GIZ)	Mbajtja e listave për numrin e saktë të personave të riatdhesuar Lista e kërkesave të tyre	Mosparaqitja e personave të Riatdhesuar	Në baza të rregullta.
Marrëveshje bashkëpunimi me TDH(Terre Des Hommes)	Ndihma ofruar fëmijëve të familjeve në nevojë, fëmijëve të abuzuar, ofrimi i trajnimeve etj. .	Numri i fëmijëve, vizitat në teren		
Marrëveshje bashkëpunimi me Kryqin e Kuq	Ngritje profesionale e personave të riatdhesuar(Trajnime duke u pajisur me Diploma)	Ofrimi i listave nga ZKKK Pjesëmarrja e personave të riatdhesuar në trajnime	Mosparaqitja e personave të riatdhesuar në trajnim	Në baza të rregullta.

Qëllimi 3: Bashkëpunimi me sektorin e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit lokal të komuniteteve

Qëllimi veprues	Aktiviteti	Indikatorët matës	Risku dhe Supozimi	Afati kohor
1. Forcimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe përfaqësuesit lokal të komuniteteve	Vlerësimi i nevojave ku si cak janë komunitetet jo shumicë, personat e zhvendosur në komunë dhe personat e riatdhesuar. Të shpërndahen rezultatet e vlerësimit tek të gjithë partnerët dhe grupet e interesit. Të organizohen aktivitete vetëdijesimi në të gjitha gjuhët e komuniteteve.	Raportet e shkruara. Numri i takimeve të organizuara Fletëpalosjet	Mungesë bashkëpunimi. Mungesa e personelit. Mungesa e burimeve.	Vlerësimi i nevojave dhe shpërndarja Janar-Qershor 2020 Kampanjë vetëdijesimi Janar-Prill 2020

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

për vlerësimin dhe raportimin e përparimeve në realizimin e të gjitha aktiviteteve të cilat ndihmojnë në jetësimin e planit të integritetit. Mungesat në krijimin e një sistemi të mirëfilltë për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut në komunë, ne jemi përpjekur që t'i kompensojmë me përvojën dhe profesionalizmin tonë në auditim dhe në menaxhim të rrezikut.

Siç shihet edhe në Planin Strategjik, Universi i Auditimit është shumë i gjerë dhe i gjithanshëm. Nga kjo del se orientimi i aktiviteteve audituese është shumë proces i vështirë në veçanti kur ka edhe kufizime në staf.

Plani Strategjik, si dhe Plan i Punës për aktivitetet audituese brenda vitit 2020 janë të hartuara në funksion të arritjes së objektivave strategjike të Komunës të parashtruara në dokumentet strategjike që i ka nxjerrë komuna si për zhvillimin strategjik, kornizën afatmesme të shpenzimeve etj., të parapara me dokumentet strategjike.

Instituti i Auditorëve të Brendshëm (IAB), standardet e të cilit janë bazë e Standardeve të Auditimit të Brendshëm në vet Republikën e Kosovës, e përshkruan Auditimin e Brendshëm si:

Auditimi i brendshëm është aktivitet i pavarur, aktivitet me siguri të arsyeshme, objektive, dhe konsultativ, i përcaktuar që të shtoj vlerat dhe të përmirësoj funksionet e organizatës. Ky aktivitet ndihmon menaxhmentin në rritjen e vlerës dhe në vendimmarrje.

Ai ndihmon organizatën që të përmbushë objektivat e saja duke paraqitur një qasje sistematike, profesionale dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektshmërinë e procesit të menaxhimit të rrezikut, kontrollit të brendshëm dhe vendimmarrjes.

Auditimi i brendshëm është një funksion vlerësues i pavarur i cili mbledh, klasifikon, vlerëson dhe raporton të dhënat duke i ofruar menaxhmentit një siguri të arsyeshme dhe të besueshme se në çfarë mase janë duke u përmbushur objektivat e sistemit dhe në çfarë shkalle të rrezikut gjendet ai sistem nga keqinterpretimet, keq menaxhimet, keq deklarimet, shpërdorimet, mashtrimet, humbjet etj.

Llojet e auditimeve që do të kryhen në këtë vit paraqesin tri tipat e auditimit si: auditimet preventive (parandaluese), auditimet detektive (zbuluese), dhe auditimet direktive (nxitëse).

Auditimet preventive kanë për qëllim parandalimin e ngjarjeve të pa dëshirueshme dhe kanë të bëjnë me këshillimet e menaxhmentit gjatë vendimmarrjes. Në këtë grup hynë edhe shërbimet këshillëdhënëse dhe të konsulencës që stafi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm do të ofroi gjatë periudhës që mbulohet nga ky Plan i punës.

Auditimet detektive janë auditime zbuluese (ex-post) dhe zakonisht përfundojnë me një numër të rekomandimeve për vëmendje për menaxhmentin.

Auditimet direktive përdoren për të shkaktuar dhe inkurajuar (për të nxitur) ndodhjen e ngjarjeve të dëshirueshme.

Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet përcjelljes së rekomandimeve të dhëna gjatë auditimeve të mëparshme.

Njësia e Auditimit të Brendshëm do të raportoj pas çdo auditimi të kryer me Raport të Auditimit dhe po ashtu do të raportoj edhe në baza gjashtëmujore siç parashihet edhe me Ligj përmes formave standarde të raportimit në Komitetin e Auditimit dhe në NJQHAB në Ministrinë e Financave. Njëherit këto organe do të

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

Avancimi i vazhdueshëm profesional do të jetë edhe këtë vit në fokus të veçantë . Në këtë aspekt do të vijohen trajnimet e organizuara nga MEF-i dhe Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm .

Pjesë e punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm do të jetë edhe bashkëpunimi dhe asistenca gjatë kryerjes së auditimit të rregullt vjetor nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm do të përgatitë dhe të raportojë në periudha gjashtëmujore edhe në Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm dhe Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës.

Për këtë, Auditori i Brendshëm do të dërgoi këtë Plan të punës në NJQHAB deri në fund të muajit Dhjetor 2019.

Raportimet tjera do të ndodhin sipas kërkesave siç është e paraparë me Ligjin për Kontrollin e Brendshëm në Kosovë.

Pas çdo auditimi, do të hartohet Raporti i auditimit me të gjitha të gjeturat dhe rekomandimet . Këto rekomandime do të jenë në funksion të eliminimit të shkaqeve që kanë qarë deri te të gjeturat e pa dëshirueshme.

Para hartimit të këtij Plani vjetor të punës, është bërë përcaktimi i universit të auditimit dhe janë identifikuar të gjitha rreziqet e mundshme me të cilat mund të përballë Komuna.

Vlerësimi i rregullt i shkallës së rrezikut do të kryhet gjatë auditimeve të vitit 2020 si dhe do të bëhet një vlerësim i ri i shkallës së rrezikut ndaj të cilit ekspozohet sistemi.

Ky vlerësim do të kryhet në bashkëpunim me Komitetin e Auditimit i cili tani më ka një përvojë pune dhe është i aftë për të vlerësuar drejtë shkallën e rrezikut në të cilën ndodhet sistemi përmes shqyrtimit të rregullt të të gjitha raporteve të auditimit gjatë viteve të kaluara.

Shkalla e komparacionit me vlerësimet paraprake do të përdoret për të vërejtur përparimet apo ngecjet në zvogëlimin e rrezikut në përgjithësi.

Vlerësimi i implementimit të rekomandimeve të dhëna gjatë viteve të mëparshme do ta karakterizoi çdo auditim që do të kryhet gjatë këtij viti.

Me Planin strategjik është përcaktuar Universi i auditimit i cili paraqet një listë shumë të gjerë të të gjitha njësive organizative, sistemeve, kategorive dhe programeve që duhet të auditohen.

Kjo listë përfshinë një numër prej 13 njësive dhe programeve dhe është e shprehur në mënyrë shumë sintetike.

Duke pasur parasysh kapacitetet audituese të Auditimit të Brendshëm në Komunë, ne jemi përpjekur që këtë Plan të punës ta hartojmë në mënyrën më të mirë që të mund të mbulohet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, pasi që kemi kufizime në staf dhe buxhet për shtimin e këtyre kapaciteteve. Duke u bazuar në kapacitetet ekzistuese, ne kemi hartuar këtë Plan të punës një vjeçare për auditimet të cilat mendojmë se do të mund të kryhen gjatë vitit 2020 duke mos mundur që të përfshijmë të gjitha auditimet të cilat janë të parapara sipas Planit Strategjik për vitin 2020. Shpeshësia e frekuentimit tek disa nga sistemet me rrezik të lartë nuk do të jetë e mundur të realizohet për shkak të kapaciteteve të kufizuara ekzistuese. Me resurset

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

Indeksi i rrezikut	Lloji i detyrave të auditimit	Njësia strukturale	Objektivi i detyrës	Fushëveprimi i detyrës	Periudha
			-Ka kontrolle të mjaftueshme në lidhje me të hyrat. -Ka ndarje të duhur të detyrave . -Transaksionet regjistrohen me kohë dhe në shumë të duhur.		
I mesëm	AAS-20-4	Drejtoria e Financave Sektori i Tatimit në pronën e paluajtshme.	Vlerësimi i veprimtarisë së menaxhimit financiar dhe kontrollit në procese dhe pajtueshmërisë me kornizën ligjore - Ka bazë ligjore dhe organizim të proceseve për mbledhjen e të hyrave. -Ka azhuritet në mbledhje, deponim dhe transfer të të hyrave. -Ekziston planifikim vjetor i inkasimit të hyrave. -Ka kontrolle të mjaftueshme në lidhje me të hyrat. -Transaksionet regjistrohen me kohë dhe në shumë të duhur.	Rregullat dhe procedurat e brendshme, kontratat dhe procedurat publike, sinjalet nga qytetarët. Vlerësimi i pasurisë së tatueshme. Aplikimi i Ligjit të ri për Tatimin në Pronë.	Korrik-Gusht
I lartë	AAS-20-5	Drejtoria e Financave Sektori i Financave/ pagesat	Rishikimi i sistemeve të vendosura të kontrollit të brendshëm dhe përputhshmërisë së tyre me ligjet dhe rregulloret. - Proceset e shpenzimit janë të organizuara në mënyrë të duhur; - Ka ndarje të duhur të detyrave të punës gjatë procesit të shpenzimeve; - Ekziston planifikim i qartë dhe përmbajtje e planit të shpenzimeve; - Ka autorizim të duhur të shpenzimeve të bëra. - Ka klasifikim të duhur të shpenzimeve në kodet adekuate. - Ka shpenzim të buxhetit në proporcion me kohën (periudhën) e kaluar të vitit fiskal. - Pagesat e projekteve kapitale janë bërë vetëm sipas kodeve të projekteve të aprovuara me buxhetin vjetor. - Shënimet përcillen me kohë dhe në shuma të sakta në raportet financiare të krijuara gjatë vitit. - Gjatë procesit të shpenzimeve synohen të arrihen objektivat e përgjithshme të Komunës.	Buxhetet e planifikuara, buxhetet e realizuara, vendimet e menaxhmentit dhe procedurat e brendshme për periudhën 2020	Shtator-Tetor

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

Detyrat e auditimit për vitin 2020 janë në përputhje me detyrat e aprovuara në planin strategjik për vitet 2020 - 2022.

Lidhja ndërmjet detyrave të planifikuara në planin strategjik dhe planit vjetor tregohet në tabelë, si më poshtë:

Llojet e detyrave të auditimit	Numri i detyrave për vitin 2020	Numri i përgjithshëm i ditëve në vitin 2020	Detyrat e auditimit sipas planit strategjik	Implementimi i planit në përqindje
Detyrat për shërbimet e sigurisë	6	163	11	55.00 %
<i>Rrezik i lartë</i>	3	180 3 detyra X 60 ditë =180	3	100 %
<i>Rrezik i mesëm</i>	3	90 3 detyra X 30 ditë =90	6	50 %
<i>Rrezik i ulët</i>	0	0	2	0%
Ndjekja e rekomandimeve	1	5 5 x 1 auditorë = 5 ditë në total	1	100 %
Detyrat për shërbime këshillimi	2	5 5 ditë x 1 auditor = 5	0	100 %

Auditori	Totali i ditëve të punës	Pushimet vjetore	Pushimet mjekësore	KEP	Trajnimet	Punë admin.	Planifikimi strategjik dhe vjetor	Monitorimi periodik dhe sigurimi i	Auditimet	Shërbimet këshilluese	Auditimet
Udhëheqës i NJAB-së	250	32	10	208	25	35	20	15	0	10	103
Auditori 1	125	23	15	87	18	4	2	1	0	2	60
Totali:	375	55	25	295	43	39	22	16	0	12	163

Ndarja e detyrave të auditimit

Koha efektive e punës (KEP)

Programi kohor për detyrat e auditimit dhe ndarja e punonjësve të NJAB-së në detyrat e auditimit për 2020:

Trem ujori	Nr.	Detyrat e auditimit	Prioriteti i njësisë së synuar	Person-ditë	Udhëheqësi i ekipit	Anëtarët e ekipit	
TM1	1	AAS-20-01	<i>Rrezik i lartë</i>	60 x 1	Udhëheqësi i NJAB-it	0	0

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

1. Harton akte normative si dhe aktet tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtaria e institucionit në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi; 15%
2. Siguron përputhshmërinë e projektligjeve dhe akteve tjera nënligjore me legjislacionin në fuqi në Kosovë; 15%
3. Kujdeset që përmbajtja dhe forma e aktit normativ të është sa më e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik si dhe të jenë identike në të tri gjuhët zyrtare; 15%
4. Bën hulumtime dhe analiza të informatave në temat e caktuara nga mbikëqyrësi dhe identifikon opsionet ose çështjet për shqyrtim; 15%
5. Sipas kërkesës dhe sipas udhëzimeve të nivelit më të lartë jep opinione ligjore si dhe bën hartimin e projekt marrëveshjeve, projektvendimeve dhe projekt akteve të tjera; 10%
6. Bashkëpunon dhe komunikon me njësitë tjera brenda dhe jashtë institucionit për aktivitetet që ndërlihen me fushën e legjislacionit; 20%
7. Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkohen kohë pas kohe nga mbikëqyrësi; 10%

Të priturat : organizim dhe bashkëpunim i ndërsjellë me njësitë brenda dhe jashtë institucionit për aktivitetet që ndërlihen me fushën e legjislacionit dhe zbatim i legjislacionit në fuqi .

4. PLANIFIKIMET SIPAS DREJTORIVE

4.1. ADMINISTRATA DHE PERSONELI

Objektivat	Aktivitetet	Bartësit e aktiviteteve	Treguesit	Afati Kohor	Buxheti (burimet financiare)
Qendra për Shërbime të Qytetarëve					
Organizimi i QSHQK-së për të siguruar shërbime sa më cilësore, efikase, efektive dhe transparente ndaj qytetarëve në kohë sa më të shkurtër.	Hartimi i planit vjetor të punës	Udhëheqësi i Sektorit	Pranimi, protokollimi dhe dorëzimi.	Janar 2020	
Udhëzimi, këshillimi dhe ndihma teknike administrative për mënyrën e plotësimit të kërkesave të qytetarëve	Mbikëqyrja e stafit dhe këshillimi e ndihma e qytetarëve	-//-	Përformanca para qytetarëve.	Gjatë tërë vitit 2020	
Orientimi dhe informimi i		-//-		Dhjetor 2020	

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

nevojshëm i shikon dhe pasi të bindet se fondet ekzistojnë inicion prokurimet për mallra, shërbime dhe punë Harton kushtet dhe kriteret e njoftimeve për kontrata dhe dosje të tenderëve Cakton anëtarët e komisioneve për hapje dhe vlerësim të ofertave dhe është i vetmi person që bën publikimin e propozuesit për dhënie të kontratës duke u nënshkruar në raportin e vlerësimit Në emër dhe për llogari të Komunës - agjencie shpenzuese (administratës, arsimit dhe shëndetësisë) i nënshkruan kontratat me operatorët ekonom.	prokurimit, shqyrtimi edhe nga KPF	Udh. Sektorit	Dorëzimi dhe protokollimi, dërgimi në KPF	Shqyrtimi në KPF	
	Inicimi i prokurimeve për mallra e shërbime sipas kërkesave të programeve Hartimi i kushteve e kriterëve për njoftime për kontrata dhe dosje të tenderëve.	Udh. Sektorit me zyrtarët	Pranimi e hartimi i dosjeve për prokurim sipas kërkesave të agjencie buxhetore Dosje të përgatitura mirë me para masa e paralogari të cilat vijnë nga njësitë kërkuese.	Tërë vitin 2020 Sipas kërkesave të zhvillimit të procedurave	
	Formimi i komisioneve për hapje dhe vlerësim të tenderëve, publikimi i propozuesit për dhënie kontrate.	Udh. Sektorit, stafi		Ad-hoc	
	Nënshkrimi i kontratave me operatorë ekonomikë në emër dhe për llogari të Komunës – agjencie shpenzuese	Udh. Sektorit	Zbatimi i Vendimit të Kryetarit të Komunës për listën e anëtarëve të komisioneve	Sipas Ligjit të Prokurimit Publik	
	Udhëheqja me komisionet vlerësuese	Udh. Sektorit	Kontrata të nënshkruara	Sipas nevojave periodike	
	Furnizimi me material zyrtar	ZLPP		Janar 2020	
		Udh. Sektorit	Shqyrtimi i dosjeve ofertuese – rekomandimet		
		Udh. Sektorit	Vendimet e shërbimit të personelit		
Planifikon pushimet vjetore të zyrtarëve					

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

administrative në Komunë. Rrjeti shtetëror në tërë territorin e Komunës Komunikimi me Qendrën Shtetërore e të Dhënave-Sistemi i telefonisë Dhoma e serverëve në Institucionet Komunale. Posta Elektronike Zyrtare (e-maili zyrtar).Sistemi për llogaritë elektronike. Sistemi i komunikimit LYNC. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i CMS-it të Ueb- faqes. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i e-Portalit Shtetëror. Sistemi i Arkivimit elektronik. Sistemi i e-Pasurisë. Intraneti, Arka Dixhitale, Arkiva Pasive, Tatimi në pronë FreeBalance, Aplikimet Online, Zyrat e Biznes, Gjeodezia, Urbaniz.	Menaxhimi i Teknologjisë Informative (harduerit e softuerit) dhe aplikacioneve dixhitale; Planifikimi dhe hartimi i pajisjeve elektronike për nevoja të Komunës Zbatimi i aplikimit online Sistemi VOIP tel.	Udh. Sektorit	dhe kryerja e shërbimeve për qytetarë, efikasiteti dhe efektiviteti i shërbimeve në cilësi dhe kohë sa më të shkurtër, që siguron kënaqshmërinë e qytetarëve	Gjatë gjithë vitit 2020	
		Udh. Sektorit		Gjatë gjithë vitit 2020	
		Udh. Sektorit	Funksionaliteti i rrjetit dhe i llogarive elektronike të zyrtarëve	Gjatë gjithë vitit 2020	
	Mbikëqyrja e rrjetit qeveritar në inst. kom. Hapja e llogarive për zyrtarë, mirëmbajtja	Udh. Sektorit	Ueb-faqja	Gjatë gjithë vitit 2020	
	Mirëmbajtja e sistemit të komunikimit LYNC	Udh. Sektorit	Llogaritë elektronike funksionale, arkivimi dhe zbatimi i aplikacioneve të reja	Gjatë gjithë vitit 2020	
	Modifikimet e mirëmbajtja në strukturën e ueb-it.	Udh. Sektorit			
Implementimi i Strategjisë për e-Qeverisje 2020-2025	Mirëmbajtja e sistemit të arkivimit, krijimi i llogarive të reja në bazë të kërkesave të Zyrës së Personelit për aplikacionet e dhëna	Udh. Sektorit	Aftësimi i stafit në përdorimin dhe zgjerimin e shërbimeve dixhitale		
		Udh. Sektorit	Sipas kërkesave,		

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

për arkivim në arkivin komunal. Seancat e Kuvendit	mbylljen e tyre për Arkiv. Menaxhimi me sistemin e teleprezencës, Votimi Elektronik dhe Incizimi i seancave	Udh. i Sektorit Zyrtari	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 01/2019 Për Monitorimin e Kuvendeve Komunale Përmes Pajisjeve të Teknologjisë Informative "TELEPREZENC AVE"	Çdo muaj	
5. Gjendja civile					
*Hartimi i planit të punës i Sektorit të Gjendjes Civile	Hartimi i planit të punës Menaxhimi dhe kontrollimi	Udh. i Sektorit, Drejtori	Performanca e shërbimeve të përditshme	Janar 2020	
*Azhurnimi i punëve sektoriale	i punës së përditshme të shërbimit e stafit, edhe në terren	Udh. i Sektorit Zyrtari	Dorëzimi e protokollimi	Çdo ditë Janar 2020 Tërë vitin 2020	
*Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve	Pranimi, kompletimi dhe dorëzimi i lëndëve të fitimit/ humbjes së shtetësisë	Zyrtarët	Mbajtja e dosjeve të lëndëve		
* Respektimi i akteve ligjore; të drejtat dhe detyrimet e zyrtarëve të gj.c.			Statistikat ditore dhe periodeke të lëndëve të proceduara nëpërmjet sistemit të intranetit	Tërë vitin 2020	
*Efikasiteti dhe efektiviteti i shërbimit të gjendjes civile;	Dakordim për trajnime me ARC/MPB	Udh. i Sektorit, zyrtarët		Tërë vitin 2020	
*Planifikimi dhe shpërndarja e detyrave zyrtarëve të gjendjes civile;	Respektimi dhe sjellja në raport me Kodin e Mirësjelljes e Z.GJ.C.; njohja me aktet ligjore	Zyrtarët	-II-		
		Udh. i Sektorit		Janar 2020	

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

* Respektimi i akteve ligjore; të drejtat dhe detyrimet e zyrtarëve	lëndëve për arkivim	Zyrtarët	Statistikat ditore dhe periodike të lëndëve të proceduara nëpërmjet sistemit të intranetit	Tërë vitin 2020	
*Efikasiteti dhe efektiviteti i shërbimit të Arkivit	Dakordim për trajnime me ASHI- në për E-Arkiva	Udh. i Sektorit, zyrtarët			
	Shqyrtimi i lëndëve sipas kërkesave të palëve dhe Arkivimin				

4.2. DREJTORIA E ARSIMIT

Punët dhe detyrat e planifikuara sipas muajve:

(Janar – Mars), 2020

Organizimi i takimeve të rregullta me drejtorët e shkollave, organet komunale, Bankën Botërore dhe MASHT;
 Takime të rregullta me drejtorët e shkollave;
 Analiza e suksesit për gjysmë vjetorin e parë për vitin shkollor 2019-2020;
 Përgatitja dhe fillimi i gjysmëvjetorit të dytë për vitin shkollor 2019 -2020;
 Zhvillimi dhe avancimi i procesit mësimor në të gjitha nivelet shkollore: (parashkollor, arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët, arsimin e mesëm të lartë dhe);
 Objektivat dhe aktivitetet për avancimin e procesit arsimor;
 Bëhet shpërndarja e mjeteve për TM1, për nevojat e shkollave në tremujorin e parë, sipas planifikimit të buxhetit për vitin 2018;
 Organizimi i Shërbimit Pedagogjik –Psikologjik nëpër shkolla;
 Vlerësimi sistematik i Nxënësve me Nevoja të Veçanta nga Ekipi për Vlerësimin Pedagogjik të Nxënësve me Nevoja të Veçanta (Zyrtari komunal i arsimit gjithëpërfshirës, Psikologu, Punëtori social dhe Mësimdhënësi mbështetës);
 Shpallja dhe shqyrtimi i konkurseve nga sektori i arsimit;
 Regjistrimi i inventarit në të gjitha shkollat e Komunës sonë;
 Zbatimi i politikës dhe Udhëzimeve Administrative të MASHT;
 Monitorimi kontinual i procesit mësimor në shkolla përmes zyrtarëve të arsimit, drejtorit të DKA-së dhe ekipit profesional të formuar me vendimin e Kryetarit të Komunës;
 Sigurimi i cilësisë në arsim përmes koordinatorëve të cilësisë në nivel shkolle dhe Komune;
 Realizimi i pagesave (zotimeve) për shkollat, të cilat i sjellin në DKA në afatin e paraparë, si KZB, UOP etj. ;
 Analiza e buxhetit për çdo muaj për (paga, MSH, komunal, subvencione dhe kapitale) ;
 Pranimi i ndryshimeve në paga nga të gjitha shkollat si dhe dorëzimi i tyre në fillim të çdo muaji;
 Raportet e punës së drejtorëve për çdo muaj;

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

Takime në MF dhe MASHT ;

Përgatitjet për shpalljen e konkursit për pranim të punëtorëve;

Planifikimi i pushimeve vjetore të punëtorëve të DKA-së;

Përfundimi i planifikimit të buxhetit për vitin 2020;

Shpallja e konkursit për kuadrin edukativo-arsimor për vitin shkollor 2020-2021;

Përgatitjet higjieno-teknike për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021;

Monitorimi i vazhdueshëm i realizimit të projekteve kapitale sipas planit dinamik;

Nënalokimi i pagave për muajt: Korrik, Gusht dhe Shtator 2020

(TETOR – DHJETOR), 2020

Fillimi i vitit të ri shkollor 2020/2021, sipas kalendarit të MASHT;

Takime të rregullta me drejtorët e shkollave;

Takime të rregullta në MASHT;

Furnizimi i shkollave me dokumentacion pedagogjik dhe material shpenzues;

Sigurimi i lëndës djegëse për shkolla;

Shpallja e konkursit për bursa për studentët

Monitorimi i procesit mësimor në shkolla në vazhdimësi;

Bëhen pagesat (zotimet) për shkollat, të cilat i sjellin në drejtori në afatin e paraparë, si KZB, UOP etj.;

Përfundimi i të gjitha pagesave, pasi që mbyllet sistemi Free Balance deri më 31.10.2019 për kapitale si dhe për mallra dhe shërbime;

Raportet e punës së drejtorëve për çdo muaj;

Realizimi i planprogramit të punës për vitin 2020;

Analiza e shpenzimeve buxhetore për vitin 2020;

Nënalokimi i pagave për muajt: Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2020.

Projektet kapitale për vitin 2020		
1	Ndërtimi i depove për lëndë djegëse	20,000.00€
2	Ndërtimi rrethimi fushave sportive	76,000.00€
3	Renovimi i nyjave sanitare	30,000.00€
4	Ndërtimi i platove për rreshtimin e nxënësve dhe trotuareve me kubëza	40,000.00€
5	Inventarizimi i shkollave	30,000.00€
6	Furnizimi i shkollave me pajisje të TIK-ut	40,000.00€
7	Furnizimi i shkollave me kabinete për kimi, fizikë, biologji	60,00.00€
8	Rrethoja e oborreve të shkollave	60,000.00€
9	Renovimi i shkollave dhe objekteve shkollore (kulme, dysheme dhe ndërrimi i dyerve dhe dritareve)	60,000.00€
10	Riparimi ngrohjeve qendrore (radiator, dysheme dhe pajisje tjera përcjellëse	10,000.00€
11	Ngjyrosja dhe suvatimi i objekteve shkollore	38,420.00€

4.3. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT


DETYRAT E DREJTORISË PËR KULTURË, RINI, SPORT, BIBLIOTEKA, ARKIV.

Koordinon dhe organizon punët në zhvillimin e kulturës;

Udhëheqë aktivitetin e SHKA-ve amatore;

Kryen punët në lidhje me bibliotekat e Komunës;

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE



Sektori i Kulturës

Objektivat kryesore të Sektorit të Kulturës janë të përqendruara në realizimin e këtyre punëve dhe detyrave:

Përgatitja e raportit të punë për vitin 2019 dhe programit për vitin 2020.

Analiza e punës dhe aktiviteteve me SHKA-të e bashkësive lokale të Komunës së Drenasit;

Konsulta me arsimtarët e muzikës të shkollave fillore rreth festivalit të grupeve artistike të shkollave fillore rreth kritereve për vitin 2020.

Përgatitja e propozicioneve për festivalin e GKA dhe shpërndarja e tyre në shkolla ku zhvillohet aktiviteti.

Program artistik për Ditë të Pavarësisë;

Përgatitjet për sofrën poetike "Ymer Elshani" 2020

Sofra poetike "Ymer Elshani" 2020.

Organizimi dhe shërimi i aktivitetit kulturor "Revista Folklorike Burimore Shqiptare 2020";

Program artistik për 14 Qershorin ditën e Çlirimit të Drenasit.

Program artistik për mërgimtarët/ "Muaji i Mërgatës".

Koordinimi rreth riaktivizimit të mundshëm të shoqërive amatore në zona rurale

Angazhimi i dy shfaqjeve nga teatri;

Përkrahja e projekteve për botime, furnizim me literaturë etj. rreth shtatë projekte.

Përgatitjet për Festivalin "Ditët e humorit Drenasi 2020".

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

Do të bëhen vizita në të gjitha arkivat e organizatave të ndryshme për tu njohur më për se afërmi me gjendjen e lëndës.

Do të tubohen dhe të merren memoaret – kujtimet e individëve të caktuar për ngjarje të caktuara si çështje sistemore për arsim, shëndetësi, ekonomi dhe lëmit shoqërore gjatë periodës së sundimit të dhunshëm, njëherit në mënyrë të veçantë do të merren kujtimet nga personat e vjetër për ngjarjet e caktuara.

Depoja mbikëqyret, kujdeset për lëndën në depo vendosjen e kutive në rafte të caktuara, ajrosja, kontrollimi i temperaturës si dhe evidentimi i fondeve. Gjatë kësaj periudhe qytetarëve nga shërbimi i brendshëm dhe i depos do të ju ofrohen dokumente të ndryshme si dëshmi dhe certifikata. Plan detal mujor javor dhe ditor mbetet në Arkivin Historik në Drenas.

Biblioteka

Gjatë vitit 2020 do të punohet kryesisht në:

Sigurimin e fondit të librave;

Klasifikimin e librave sipas natyrës dhe veprimtarive.

Përpunimin e librit.

Klasifikimin e librit.

Dhënia e signaturave të librit.

Përpunimin e Katalogut të bibliotekës.

Renditjen e librave në rafte .

Biblioteka do të shtoj numrin e lexuesve.

Dhënie e librit në lexim.

Pranimin e librave nga lexuesit.

Evidentimin e lexuesve me kartonë të lexuesve.

Do të kryhen edhe punët tjera si ato administrative dhe pastrimi i librit dhe lokalit në përgjithësi.

MASAT PROPOZUESE TË DKRS-së

Krahasuar me planin e punës, obligimet ligjore dhe burimet buxhetore, vlerësojmë se pjesa qendrore e objektivave për vitin 2019 në lëmin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit janë përmbushur, por për të pasur një jetë më të begatshme kulturore dhe sportive në Drenas mendojmë se imperativ janë këto objektiva, të cilat mund të përmbushen me buxhetin e paraparë për vitin 2020.

Renovimi i Objektit të Arkivit Komunal;

Fusha Sportive dhe Rekreacion;

Renovimi i Objekteve Sportive;

Projekte në proces:

Ndërtimi i Stadiumit faza e dytë;

Ndërtimi i Stadiumit Sintetik në Komoran;

Ndërtimi i Pishinës Gjysmë Olimpikë në Komoran.

Domosdoshmëri e funksionimit më të mirë të DKRS-së dhe krijimit të hapësirës dhe ambientit më të mirë për të rinjtë, për këtë qëllim është e domosdoshme mbështetja e të gjitha organeve të Komunës së Drenasit që të këto projekte të sendërtohen gjatë vitit që kemi hyrë sipas planifikimit.

Masa buxhetore e planifikuar në gjashtë kategoritë buxhetore për vitet 2020-2021 dhe 2022.

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

Ligjin 03/L-153 Për ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës .

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZHR), ka këto detyra dhe përgjegjësi.

Implementon politikat zhvillimore në sektorët e Bujqësisë.

Koordinon dhe mbikëqyrë asociacionet Bujqësore.

Përgatit planet për mbjelljet pranverore, vjeshtore dhe fushatën për korrje-shirje.

Funksionimi i Qendrës Informative Këshilluese Komunale në Bujqësi.

Organizon trajnime dhe këshillime për fermerët.

Jep pëlqim për rikultivimin e tokave Bujqësore.

Mban evidencën për tokat Bujqësore .

Bashkëpunim dhe përkrahjen e aktiviteteve rreth ujitjes në Kompaninë e "Ibër Lepencit" .

Bënë mbrojtjen e resurseve natyrore duke përfshirë pyjet, rërën (zhavorrin) dhe aktivitetet tjera rreth gurëthyesve.

Koordinon punët dhe bashkëvepron me OJQ-të që përkrahin aktivitetet Bujqësore.

Bashkëpunon me agjencionet qeveritare për zhvillimin e rajoneve rurale.

Planifikon zhvillimin dhe kujdesin permanent të shfrytëzimit të tokës Bujqësore për nevojat dhe interesat e Komunës.

Bashkëpunimi dhe koordinimi me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Mbrojtja e Pyjeve, Pyllëzimi dhe Ripyllëzimi.

Planifikimi i Zhvillimit Rural.

Hulumton resurset natyrore duke përfshirë edhe mbrojtjen e shtazëve dhe bimëve.

PLAN PROGRAMI I PUNËS NË PIKA TË SHKURTA

DBPZHR ka këto Aktivitete të punës (Janar- Dhjetor 2020)

Monitorimi i të mbjellave Vjeshtore;

Organizimi i trajnimeve për fermerë;

Përcjellja e punëve tjera të drejtorisë – përpunimi i kërkesave 2019 ;

Ofrimi i shërbimeve këshillimore për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, që të lehtësojë dhe ndihmojë më tej vetë iniciativat e fermerëve dhe komuniteteve rurale ;

Dhënia e këshillave për fermer, praktikimi i krasitjes së pemëve të fermerët që posedojnë plantacione të pemëve, si dhe dhënia e këshillave për mbrojtjen e bimëve dhe dëmtuesve si dhe mirëmbajtjen e pemishteve;

Dhënia e informacioneve rreth grandeve për mbështetjen e fermerëve nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR);

Do të bëhet ndarja e subvencioneve nga DBPZHR në sektorë të ndryshëm;

Mbështetje fermerëve nga Bashkëpunimi në mes të Komunës së Drenasit dhe IADK-së;

Dhënia e informacioneve fermerëve rreth grandeve për mbështetjen nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR);

Pranimi i aplikacioneve dhe digjitalizimi i parcelave të fermerët për subvencionimin e grurit, misrit, pemëve, perimeve etj. dhe pranimi i aplikacioneve për sektorin e blegtorisë në kuadër të subvencionimit nga MBPZHR ;

Monitorimi i të mbjellave pranverore në territorin e Komunës së Drenasit;

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

4	Konfiskimi i druve pa çekan dhe pa fletëparaqitje	Në bashkëpunim me Policinë dhe Inspeksionin do të konfiskohen drutë pa dokumente zyrtare të lëshuara nga organi kompetent Komunal, si dhe matja e tyre nga ana e teknikut pylltarisë	Shefi i sektorit, Policia, Inspeksioni dhe tekniku i pylltarisë.	Gjatë gjithë vitit
5	Kërkesa për kompensimin e dëmit	Përmbartimi i lendeve në gjykatë dhe përfaqësimi i lëndëve në gjykatë	Shefi i sektorit	Gjatë gjithë vitit
6	Pranimi i kërkesave për pyjet private	Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave për pyjet private	Shefi dhe tekniku i pylltarisë	Janar–Mars
7	Bashkëpunimi me organet e Komunës	Bashkëpunimi me Zjarrfikësit, Policinë, Inspektorët etj.,	Shefi i sektorit të pylltarisë dhe organet e Komunës.	Punë permanente
8	Ruajtja e pyjeve nga zjarret	Bashkëpunimi me zjarrfikësit me qëllim të shuarjes së zjarreve nëse ato ndodhin.	Shefi i pylltarisë, pylltarët, zjarrfikësit	Qershor-tetor
9	Kontrollimi i pishave dhe të gjitha terreneve	Dalja në ndihmë pylltarëve	Shefi i sektorit të pylltarisë	Punë permanente
10	Kontrollimi i ditarëve të punës	Kontrollimi i ditarëve të punës të gjithë pylltarëve	Shefi i sektorit	Gjatë gjithë vitit
11	Bashkëpunimi me agjensionin e pyjeve në Prishtinë	Përgatitja e raporteve mujore dhe dërgimi i të njëjtave në APK – Prishtinë.	Shefi i sektorit	Gjatë gjithë vitit
12	Regjistrimi i të gjitha terreneve ekonomiko pyjore për vitin 2019	Formimi i komisioneve, dalja në teren dhe regjistrimi i dëmeve pyjore	Shefi, tekniku dhe të gjithë pylltarët	Tetor-Nëntor
13	Pyllëzimi	Pyllëzimi i sipërfaqeve të reja	Shefi, tekniku i pylltarisë	Nëntor
14	Parandalimi i gjuetisë ilegale	Parandalimi i gjuetisë ilegale dhe përkujdesja për mbrojtjen e kafshëve të egra.	Roja e pyllit	Punë permanente

4.5. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Në mbështetje të statutit të Komunës së Drenasit, Nenit 83 si dhe në mbështetje të Dispozitave të Përgjithshme Administrative, Ligjeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës si dhe Rregulloreve të Komunës së Drenasit, Drejtoria e Inspeksionit ka hartuar planin e punës për vitin 2020.

Kështu që në programin e punës për vitin 2020 do të përfshihen mbikëqyrjet inspektuese sipas lëmive si vijon:

Inspektimi në lëminë e ndërtimit dhe zbatimit të planeve urbanistike, shërbimeve të infrastrukturës,

Inspektimi në lëminë e tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit,

Inspektimi në lëminë e shëndetësisë dhe mbikëqyrjet sanitaro-higjenike,

Inspektimi i bizneseve rreth dokumentacionit dhe kushteve të punës

Inspektimi në lëminë e komunikacionit rrugor

- Inspektimi në mbrojtjen e mjedisit(Mjedisit) jetësor

Inspektimet tjera sipas kërkesave dhe dispozitave të veçanta. dhe

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

5.	1. Insp i bizneseve, çmimet, 2. Insp i zbatimit të orarit të punës (Vikendeve) 3. Insp rreth hyrjes në sistem të menaxhimit mbeturinave 4. Insp rreth pastërtisë së qytetit 5. Insp i hapësirave publike (terasat etj.) 6. Insp i sall. të ondulimit, furrave të bukës për higjienë 7. Insp stacioni i autobusëve, largimi i trans. Ilegal 8. Insp. i objekteve në ndërtim në zonën e Komacionit 9. Raporti mujor	Maj	Insp i Tregut Insp i Tregut Insp i Ambientit Insp i Ambientit Insp i Ndërtimit Insp i Sanitarisë Insp i Komunikacionit Insp i Ndërtimit Drejtoria e Inspektionit
Nr.	Përshkrimi	Muaji	Mbikëqyrja
6.	1. Insp i tregjeve dhe tregtarëve lëvizës 2. Insp i restoranteve, moteleve 3. Insp rreth menaxhimit të mbeturinave 4. Insp i bizneseve dhe amvisërisë për hyrje në sist. të MM 5. Insp i hapësirave publike (terasat etj.) 6. Insp i higjienës në subjekte hoteliere 7. Insp i zbatimit të orarit të punës (autobusët) 8. Plan i buxhetit për vitin 2020-2022 (kërkesat fillestare) 9. Insp. i objekteve pa leje ndërtimore në tokën bujqësore 10. Raporti mujor	Qershor	Insp i Tregut Insp i Tregut Insp i Ambientit Insp i Ambientit Insp i Ndërtimit Insp i Sanitarisë Insp i Komunikacionit Drejtoria e Inspektionit Insp i Ndërtimit Drejtoria e Inspektionit
Nr.	Përshkrimi	Muaji	Mbikëqyrja
7.	1. Insp i zbatimit të orarit të punës (pas orës 23:00) 2. Insp i prejardhjes dhe deklaracionit të mallit 3. Insp i gurëthyesve rreth ndotjes së ambientit 4. Insp rreth hyrjes së mbeturinave në sistem të menaxhimit 5. Insp i ndërtimeve, fazat e ndërtimit me leje ndërtimore 6. Insp. i objekteve në ndërtim në zonën e Komacionit dhe tokë bujqësore 7. Insp i mallit me afat të skaduar 8. Insp i zbatimit të rendit të udhëtimit të trans.udht. 9. Raporti i punës TM-2 për vitin 2020	Korrik	Insp i Tregut Insp i Tregut Insp i Ambientit Insp i Ambientit Insp i Ndërtimit Insp i Ndërtimit Insp i Sanitarisë Insp i Komunikacionit Drejtoria e Inspektionit
Nr.	Përshkrimi	Muaji	Mbikëqyrja
8.	1. Insp i bizneseve, çmimet, deklaracioni 2. Insp i zbatimit të orarit të punës (Vikendeve) 3. Insp rreth Ndotjes së Ambientit nga (Feronikeli) 4. Insp Shfrytëzimi i zhavorrit nga operatorët ilegal 5. Insp për ndërtimet pa leje ndërtimi dhe prona publike 6. Insp. i fazave të ndërtimit me leje ndërtimore 7. Insp i shkollave (kushtet higjieno –teknike) 8. Insp stacioni i autobusëve, largimi i transportuesve ilegalë 9. Raporti mujor	Gusht	Insp i Tregut Insp i Tregut Insp i Ambientit Insp i Ambientit Insp i Ndërtimit Insp i Ndërtimit Insp i Sanitarisë Insp i Komunikacionit Drejtoria e Inspektionit
Nr.	Përshkrimi	Muaji	Mbikëqyrja
9.	1. Insp i tregjeve dhe tregtarëve lëvizës 2. Insp i restoranteve, moteleve 3. Insp i shkarkimit të ujërave të zeza 4. Insp rreth menaxhimit të Mjedisit 5. Insp i hapësirave publike (terasat etj.) 7. Insp. i ndërtimeve në pronat publike	Shtator	Insp i Tregut Insp i Tregut Insp i Ambientit Insp i Ambientit Insp i Ndërtimit Insp i Ndërtimit

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

Pasqyrat financiare 2019,

Procesi buxhetor-strategjia fiskale 2021-2023, sipas kërkesave fillestare,

Aprovimi i shpenzimeve dhe certifikimi për buxhetin komunal sipas programeve,

Kryerja e pagesave lidhur me shpenzimet operative dhe kapitale, si dhe barazimi me raportet e SIMFK,

Punët lidhur me arkën e parave të gatshme (arkëtimi dhe pagesat),

Regjistrimi në sistemin kompjuterik i të gjitha të hyrave të arkëtuara nga burimet vetanake dhe barazimi ditor, javor, mujor dhe periodik me SIMFK,

Autorizimi i shpenzimeve për D.B.F

Përcjellja e të hyrave publike të akorduara nga B.K.K,

Përgatitja e transfereve të parave të depozituara në llogaritë e thesarit të MEF-it,

Caktimi i tatimit në pronë- shpërndarja e faturave për vitin 2020,

Evidentimi i objekteve të reja si pasuri e paluajtshme dhe rimatja e objekteve,

Përgatitja e analizave mujore lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal,

Raporti i punës dhe financiar sipas periodave të vitit /2020,

Propozim korniza afatmesme buxhetore 2021-2023,

Shlyerja e pagesave për tatimin në pronë,

Plotësimi i formularëve për buxhetin 2021-2023, sipas kërkesave fillestare,

Trajnimin e punëtorëve të D.B.F,

Punë dhe detyra tjera të punës për pushtetin lokal dhe qendror,

Punët me palë në lëmin e buxhetit dhe financave.

Struktura e përgjithshme organizative për funksionet e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, tani më është e bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin për Vetëqeverisjen lokale, Statutin e Komunës, sipas Sektorit të Buxhetit, Thesarit dhe Financave.

1. Sektori i Buxhetit - Për periodën janar-dhjetor/20, do të kryej këto punë dhe detyra pune:
Zhvillimi i aktivitetit lidhur me planifikimin e buxhetit komunal 2021-2023, sipas kërkesave fillestare, përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2021-2023

vërtetime tjerë për qytetarët lidhur me rregullimin e dokumentacionit,

numri i kërkesave të regjistruara dhe koduara për shpenzime nga shfrytëzuesit e buxhetit komunal, lëshuara e faturave sipas kërkesës së palëve,

- ruajtja e data bazës për të dhënat e regjistruara, objektet e reja të matura – ri matura, fatura të shpërndara përmes poste, numri i ankesave të pranuar, pranimi i kërkesave për regjistrimin e objekteve të reja,

Sektori i Thesarit.

- Në këtë sektor, punët dhe detyrat e punës për periodën janar-dhjetor /2020, do të kryhen si vijon:

Arkëtimin e parave të imta për shërbime në ofiqari, arkiv, Gjeodezi, Urbanizëm, shërbimet e pagesës së tatimit në pronë, dhe për shpallje të tenderëve - shërbime për arkëtim të parave të imta. Përveç arkëtimit, është bërë përgatitja dhe depozitimi ditor i parave në llogarinë bankare të Komunës.

regjistrimi i të hyrave vetanake të arkëtuara është bërë për çdo ditë në data baze dhe në sistemin e Free-balancit, transferi i të hyrave vetanake nga llogaria bankare komunale në llogari të thesarit MEF për çdo fund muaji, barazimi i raporteve të arkës me raportet e bankës dhe kontrollimi i tyre për çdo ditë,

hartimi i raporteve mujore për të hyrat vetanake për nevoja të ekzekutivit dhe MEF-së,

zotimi i parave publike për qëllime të pagimit të shpenzimeve operative dhe kapitale, sipas modulit të blerjes, dhe sipas modulit të aprovimit, në numër prej,

kryerja e pagesave nga buxheti i Sektorit të Përgjithshëm (drejtorit dhe zyrat komunale) për të gjitha lëndët që janë të kompletuara,

Certifikimi UOP sipas Modulit të aprovimit,

Certifikimi i UOP sipas modulit të blerjes,

Certifikimi i avanseve për udhëtime zyrtare jashtë vendi,

Aprovimi i avanseve për udhëtim jashtë vendit,

Regjistrimi i UOP

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

QKMF "Dr. Hafir Shala" në Drenas është institucion shëndetësor me interes të veçantë, e që ushtron veprimtarin e vet kryesisht duke u bazuar në Planin e punës si dhe në Projekt –Programet e departamenteve, sektorëve dhe njësive punuese, apo zyrave dhe shërbimeve tjera si:

Përcjellë dhe studion gjendjen shëndetësore, kushtet higjienike dhe ambientale të popullatës
Zbaton masat për mbrojtjen shëndetësore prenatale, antenatale dhe postnatale të femrave, planifikimin familjar, kujdesin për shëndetin e foshnjave (zinxhiri i ngrohtë),

Kujdeset për shëndetin e fëmijëve dhe implementimi i programit të MISF-it deri në moshën 5 vjeçare, kujdesi për fëmijët parashkollor dhe shkollor, me theks të veçante adoleshentet, studentëve, promovimin e stilit të shëndetshëm të jetës si dhe edukimin e tyre për dëmet e pirjes së duhanit, alkoolit, drogave;

Kujdesi për shëndetin dhe mirëqenien e Invalidëve, personave me aftësi të kufizuara, punëtorëve, kujdesin shtëpiak dhe atë paliativ;

Zbaton programin e imunizimit dhe vaksinimit sipas kalendarit të vaksinimit;
Zbulon, parandalon dhe menaxhon me kohë sëmundjet ngjitëse, infeksionet seksualisht transmissive HIV/AIDS dhe sëmundjet tjera .

Bënë edukimin e vazhdueshëm profesionalë të stafit si dhe bënë edukimin e komunitetit sipas programeve edukativo-shëndetësor;

Zbaton masat me qëllim të parandalimit të sëmundjeve të dhëmbëve dhe gojës, si dhe edukimin e vazhdueshëm profesional të stafit përmes programeve që dalin nga Ministria e Shëndetësisë, si dhe edukimin shëndetësor të fëmijëve parashkollor-shkollor përmes ligjëratave dhe duke shpërndarë material promovues;

Implementon sistemin bazik të informimit shëndetësor SISH dhe përmirëson statistikën ekzistuese;
Implementon ligjin për ndalim të pirjes së duhanit në hapësirat e institucionit,
Zbaton programe për menaxhim të hedhurinave dhe materialet e kontaminuara,
Zbaton sistemin obligativ për sterilizim;
Zbaton sistemin e kontrollit të infeksionit;
Zbaton sistemin e hapjes së kartonëve –dosjes për çdo pacient;
Zbaton sistemin e menaxhimit të resurseve humane;
Zbaton sistemin për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe ndërtesave
Zbaton sistemin e Planit emergjent;
Zbaton programet sesione këshilluese për hipertension dhe diabet;
Zbaton sistemin e programit adekuat për furnizim, deponim dhe shpërndarjen e barërave;
Zbaton sistemin e satisfaksionit të pacientit dhe ofruesve të shërbimeve shëndetësore;
Zbaton sistemin për edukimin e stafit në shkathtësitë interpersonale, gjë që siguron që pacientët janë trajtuar me dinjitet dhe respekt;
Minimizon procedurën e vetë referimit (nga ana e pacientit) për në shërbimet sekondare dhe terciare.
Zbaton sistemin e ankesave të pacientëve;
Zbaton sistemin e konfidencialitetit;
Zbaton sistemin për dhënie të pëlqimave,
Zbaton sistemin për të drejtat e pacientëve për informim dhe vendosje,
Zbaton sistemin e performancës lidhur me ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore,

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

7. Vazhdimi i punëve për QMF Gllanasellë dhe Baicë e AMF Abri.

8. Pajisja e Autoambulancave me aparatura ECG me monitor ose defribilator me monitor, o2

Për të gjitha këto kërkohet një sigurim i mjeteve financiare –buxhetit dhe angazhim i stafit udhëheqëse në bashkëpunim me strukturat komunale dhe ato qendrore.

Gjatë vitit 2020 QKMF "Dr. Hafir Shala" Drenas do të funksionoj me këto departamente, sektorë, QMF, AMF dhe shërbime tjera si vijon.

QKMF "Dr. Hafir Shala" Drenas duke marrë për bazë shtimin e nr. e banorëve në territorin e Komunës së Drenasit dhe banorëve të komunave tjera, si dhe kujdesin e shtuar për ofrim dhe ngritje të cilësisë së shërbimeve shëndetësore në plan ka paraparë që vëllimi fizik i shërbimeve shëndetësore në këtë vit kalendarik të jetë i shtuar për 4-5% në krahasim me vitin 2019. Gjithashtu nevojitet që edhe Plani financiar –buxheti për këtë vit të jetë më i rritur për 4-5%. Për punën e gjithmbarshme për vitin kalendarik 2019/20 janë të detyruar të raportojnë Departamentet – sektorët dhe shërbimet tjera –Komiteti për ngritjen e cilësisë dhe këshillit drejtues, me qëllim që punëtorët të njoftohen mbi rrjedhën dhe procesin e punës, shërbimet e ofruara, të drejtat dhe obligimet e punëtorëve dhe pacientëve, si dhe çështje tjera. Raporti i punës paraqitet nga ana e shefit të departamentit –sektorit, apo shërbimit sipas këtyre terminëve kohore.

Dinamika e Punës për vitin 2020 do të bazohet kryesisht në Planin Komunal për Zhvillimin e Institucioneve të KPSH Drenas pas aprovimit nga ana e KUVENDIT si dhe Aprovimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administratës dhe Ministria e Shëndetësisë.

Hartimi dhe Aprovimi i Statutit të Ri për QKMF-në bazuar në Legjislacionin shëndetësor në fuqi të Ministrisë së Shëndetësisë si dhe Rregulloret të domosdoshme për Funkcionim sa më normal të shërbimeve shëndetësore bazuar në Statutin e Ri (pas Aprovimit).

Departamenti –Sektori -Shërbimi	Termini	Organit Kompetent
Departamenti –Sektori i M.F.	Çdo 3 muaj	1. Komitetit për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe 2. Këshillit drejtues
Sektori i shëndetit publik	"	"
-Njësia e SISH-it	"	"
-Njësia e Imunizimit;	"	"
-Njësia e Vaksinimit	"	"
Sektori i shëndetit oral	"	"
Sektori i kujdesit emergjent	"	"
Sektori konsultativ	"	"
- Njësia e Pediatriisë	"	"
- Njësia e Gjinekologjisë	"	"
-Njësia e Dermatologjisë	"	"
Sektori i diagnostikues	"	"

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

Zbatimi dhe implementimi i Doracakëve të miratuar nga MPMS, IPS etj.	-Doracakut për mbrojtjen e fëmijëve -Doracakut për komunikim me fëmijë -Doracakut për kujdestari dhe adoptime -Doracakut për strehim familjar dhe -Udhëzimeve Administrative Nr. 13/2012-Rregullimin e Strehimit Familjar në Kosovë -Udhëzimin Administrativ QTK Nr. 05/2013 Parandalimi dhe ndalimi i formave të rrezikshme të punës me fëmijë, si dhe standardeve të reja të miratuara nga MPMS-ja etj.	Përherë	MPMS, IPS QPS, Familjet strehuese dhe Adoptuese OJQ etj.		
Respektimi i Kodit Etik dhe ruajtja e fshehtësisë së të dhënave	Të gjithë punëtorët e QPS janë të obliguar që të respektojnë dhe t'i përmbahen parimeve të Kodit Etik dhe janë të obliguar që të dhënat nga SHS dhe SNS të mos jepen pa autorizim të eprorit, kurse çdo e dhënë që cenon personalitetin e klientit të ruhet edhe pas pushimit të marrëdhënies së punës.	Përherë	Kodi Etik		
Bashkëpunimi i QPS-së me Institucionet dhe Organizatat tjera	Për realizimin me sukses të detyrave të parashtruara-planifikuara, SHS. të Qendrës për Punë Sociale do të këtë bashkëpunim të ngushtë me Organet, Organizatat dhe institucionet lokale dhe qendrore si dhe organizatat qeveritare dhe jo qeveritare	Përherë	MPMS, DMS IPS, KK. BL. OJQ Shkollat, Familjen etj.		
Puna analitiko-hulumtuese, planifikuese dhe raportuese	Në këtë drejtim do të punohet në zbulimin, grumbullimin dhe studimin e të gjitha dukurive dhe problemeve të punës dhe mbrojtjes sociale e cila punë dhe aktivitet do të percaktohet dhe pasqyrohet përmes punimeve të ndryshme, Analizave, informatave, raporteve të shkruara apo statistikore, udhëzimeve të ndryshme etj. Gjatë vitit 2020 synojmë përveç atyre të theksuara më sipër edhe: Programin e punës së QOS-së dhe Ekiyeve për vitin 2020, Raportin e punës së	Përherë Menjëherë			

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

MIRËQENIA SOCIALE E KLIENTËVE Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve: Trajtimi adekuat dhe mbrojtja e fëmijëve pa kujdes prindor: Mbrojtja fëmijëve-foshnjave të porsalindura dhe të gjetur	Caktimi i menaxhuesit të rastit, strehimi rezidencial, caktimi i emrit personal dhe kujdestarit, hartimi i planit të përbashkët mbrojtës, identifikimi i prindërve biologjik dhe bashkimi eventual familjar, përzgjedhja e familjes strehuese apo adoptuese, themelimi i adoptimeve, vizita të rregullta dhe të pa parapara të klientëve të strehuar (institucione, strehim familjar apo familje adoptuese). Moto e punës së QOS-së do të jetë "Familje për fëmijë e jo Fëmijë për Familje". Te masa mbrojtëse e adoptimit përparësi absolute ka adoptimi vendor dhe në këtë drejtim do të respektohet Konventa e Hagës për adoptim ndërkombëtar.	Përh erë Dy herë në muaj	MPMS, DSHMS QPS, Familja, OJQ-të etj.		
Mbrojtja e fëmijëve pa të dy prindërit-pa përkujdesje prindore	Hulumtimi, evidentimi dhe ndërmarrja e të gjitha formave dhe masave mbrojtëse: Strehimi emergjent në familje tjetër sipas nevojës, Regjistrimi dhe inventarizimi i pasurisë së klientit, vënia nën kujdestari-caktimi i kujdestarit, Dërgimi i Vendimit ofiqarit dhe Kadastrit, përcjellja e zhvillimit dhe statusit të klientëve, vizitave të rregullta dhe të jashtëzakonshme në familje dhe në shkollë, Raportimi i rregullt dhe i jashtëzakonshëm nga Kujdestaret për gjendjen shëndetësore, arsimore dhe të pasurisë së klientëve.	Përh erë	QPS, KK, Familja Kujdestari, Shkollë		
Mbrojtja e fëmijëve-prindërve të cilëve u është hequr e drejta prindore	Ndërmarrja e të gjitha masave mbrojtëse ndaj fëmijës: -nëse fëmija e ka prindin tjetër- i besohet atij dhe i ndihmohet, nëse të dy prindërve u është hequr e dr. prindore-i caktohet kujdestari, do të strehohet në familje tjetër, nëse ka pasuri i regjistrohët dhe vendimi i dërgohet ofiqarit dhe kadastrit, nga kujdestari do të kërkohet raporti i rregullt dhe do të vizitohet.	Përh erë	Gjykata, QPS, KK		

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

që kanë rënë në konflikt me ligjin	bashkëpunimit me prindër të tyre, shkollat, Policin, Gjykatat, OJQ-të etj. Hartimi i raporteve hetuese me propozimin e masave edukative, pjesëmarrja në seancat gjyqësore, zbatimi i masave edukative dhe masave tjera të shqiptuara nga Gjykatat.	Përherë	Qendra Rinore, OJQ-të etj.		
Mbrojtja e fëmijëve, prindër e të cilëve janë ndarë, shkurorëzuar apo janë në procedurë të shkurorëzimit	Angazhimi dhe puna permanente në përmirësimin - sanimin e marrëdhënieve bashkëshortore dhe familjare, nëse procedura e pajtimit është e pa suksesshme do të jepet propozimi Gjykatës për besimin e fëmijëve dhe rregullimin e kontakteve personale të fëmijëve me prindin tjetër, përcjellja e zhvillimit të fëmijëve nga prindërit e shkurorëzuar-ndarë.	Përherë Mujo re	QPS, Familja, Gjykata		
Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve të trafikuar dhe të atyre që konsumojnë substanca psikoaktive	Përveç 2 rasteve të trafikuar nga vitet e mëparshme të cilat tani janë kthye familjes e përcjellim rregullisht në dhe prindi i saj dhe disa here kemi intervenuar në ndihma në natyrë dhe gjera ushqimore . Në këtë drejtim për të gjitha rastet do të aplikohen me përpikëri Standardet operative për mbrojtjen e viktimave të brendshme dhe të jashtme të trafikimit si dhe Plani nacional i veprimt. Trajtimi psiko-social i të rinjve që konsumojnë substanca, do të bëhet në bashkëpunim me institucionet e specializuara.	Përherë	QPS, MPMS, Policia, QMF, Ins.spec.		
Eliminimi i formave të rënda të punës së fëmijëve dhe ri-integrimi i tyre	Do të punohet konform ligjeve, akteve nen-ligjore në fuqi, Plani nacional i veprimt si dhe Marrëveshjes së nënshkruar me partner për eliminimin e formave të rënda të punës dhe integrimin e tyre duke shfrytëzuar përvojat e fituara me pare kur kemi arritur që t'i largojmë nga puna e rende e rrezikshme tek mbeturinat e Ferronikelit disa fëmijë, falë bashkëpunimit shkollë – familje, si dhe policisë së Drenasit kemi	Përherë	NSHS, Policia, Gjykata OJQ-të		

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

	domosdoshme që të thellohet bashkëpunimi më i ngushtë me Handikosin, Organizatat e të verbërve, shurdhëve, Distrofistëve etj. Është detyrë imediate e të gjithë ZSHS që të bëjnë evidentimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në mënyrë që të regjistrohen në shkolla për fëmijët dhe të rinjtë me nevoja të veçanta (shkolla speciale), por paraprakisht është e domosdoshme të formohen komisionet përkatëse (qoftë në nivel të Regjionit apo në nivel qendror) mbi kategorizimin e kësaj kategorie. Në fund është e domosdoshme që të kontaktohet me OJQ-të bamirëse në mënyrë që kësaj kategorie t'i ofrohen ndihma në natyrë (veshmbathje, ushqim si dhe eventualisht mjete ortopedike) nga se kjo kategori tani për tani është e injoruar dhe përjashtuar nga ndihmat në të holla pasi që me Ligjin mbi pensionet për personat me aftësi të kufizuara nuk është përfshire.				
Mbrojtja e të rriturve në nevojë	1. Edhe në të ardhmen kjo kategori do të trajtohet me përkushtim dhe se do tu ofrohen shërbime të nevojshme për të gjithë të rriturit me sjellje të çrregulluara asociale dhe në konflikt me ligjin. Do të thellohet bashkëpunimi me organet dhe institucionet kompetente që ndikojnë në realizimin sa më me sukses të trajtimit adekuat të këtyre rasteve. 2. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet edhe trajtimit adekuat në rastet ndaj të cilëve ushtrohet dhunë familjare dhe forma tjera të keqtrajtimit e sidomos ndaj femrës, ashtu sikurse parashohin dispozitat e Rregullores kundër dhunës në familje. 3. Edhe pse deri tani nuk kemi të evidentuar asnjë rast të trafikimit me njerëz të moshës së rritur, duhet të jemi të gatshëm që kësaj të keqe e cila është paraqitur në mese tjera,	Përh erë	QPS, Gjykata Familja, Komuniteti		

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

	Gjithashtu ata Pleq që nuk kanë përkujdesje familjare dhe i plotësojnë kushtet do të përcillen për në dy Shtëpitë e pleqve në Prishtinë apo Skenderaj sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara.				
Plotësimi i Standardeve sa i përket shërbimeve sociale	Pjesëmarrja në Trajnime, seminare etj. në avancimin e shërbimeve sociale konform standardeve duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe Konventat Ndërkombëtare. Tani veç ka marr formën edhe kategorizimi dhe standardizimi i disa kategorive ku do të respektohen me përpikëri, si dhe Licencimi i ZSHS.	Përh erë	MPMS, IPS, OJQ etj.	Buxheti Kosovës dhe donacio net	
Përcjellja e aplikimit të formave unike të punës për Shërbime sociale	Edhe këtë vit do të aplikohen format e punës profesionale me përkushtim dhe do të përcjelljen nga DPSF dhe DSHMS.	Përh erë	QPS, DSHS, DIPS		
Përgatitja, ri-instalimi i ndryshimeve dhe plotësimeve të Bazës së të dhënave	Punëtorët që janë të angazhuar direkt në punë në Bazën e të dhënave si dhe të gjithë ZSHS do t'i zbatojnë çdo ndryshim dhe plotësim të Bazës së të dhënave.	Gjatë tërë vitit	QPS-NSHS, DSHS,OJQ-të		
Programimi, raporti-mi dhe mbajtja e takimeve të SHS.	Do të punohet me organet komunale (Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale) dhe DSHS në drejtim të punës në kushtet e decentralizimit sipas Ligjit mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe Rregullores për qeverisjen lokale dhe lidhur me këtë do të mbahen takime konsultative në të tre nivelet (QPS-KK dhe MPMS).	Gjatë tere vitit	QPS, MPMS, KK		

Planifikimi dhe implementimi i Planit të punës për SAS

Trajtimi i barabartë i qytetarëve, Angazhim në mirëqenien e	Të gjithë qytetarët do të trajtohen njëjtë pavarësisht nacionalitetit,	Përherë	Kodi Etik, Infrastruktura ligjore.		
---	--	---------	--	--	--

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

Raportimi dhe informimi Udhëheqësit të SNS si dhe DMS-së	QPS obligohet që në mënyrë të sakët, të plotë dhe me kohë të informojë në formë raporti apo informate lidhur me: -numrin e shfrytëzuesve, -numrin e aplikuesëve të rinj dhe të larguar si dhe të dhëna tjera relevante.	Mujor, Gjashtë mujor, Vjetor.	QPS DSHMS		
Përpilimi i Planit operativ-dinamik dhe takimi me NSNS	QPS do të nxjerrë Planin e vetë operativ dinamik në bazë të Rregullores implementuese lidhur me detyrat e parashtruara dhe realizimin e tyre.	Mujor, dhe Vjetor	QPS, DSHMS		
Inicimi i lendeve për Gjykatë	Identifikimi i të gjitha rasteve të cilat kane realizuar ndihme sociale pa baze ligjore, do të iniciohet procedure ligjore(përmes DPSF) për kthimin e këtyre pagesave.	Udhëzimi ad. për kthimin e pagesave nr. 08/2010			

Planifikim i punëve për vitin 2020 Sektori Administrativo -Financiar

Implementimi i ligjeve dhe rregulloreve në fuqi që kanë të bëjnë me administratë dhe financa	Kujdesja permanente për implementimin dhe realizimin e nevojave dhe përcjelljen e shpenzimeve të dhëna lidhur me mjete Financiare. 1. Si dhe përcjellja e gjendjes Financiare si dhe kryerja e të gjitha pagesave për QPS-në; 2. Shfrytëzimi racional i mjeteve në bazë të alokimeve të lejuara. 3. Përpilimi i raporteve financiare; 4. Njoftim me kohë i furnitorëve për pagesat e bëra; 5. Realizimi i këtij plani bëhet në bazë të udhëzimeve të dhëna nga DSHMS-ja, Drejtori në bashkëpunim me Lideri e shërbimeve dhe me NAF.	Përherë	<u>QPS-</u> <u>DSHMS</u>		
Kursimi racional i mjeteve dhe shpenzimeve	Këtë vit sikurse edhe deri me tani do të kemi kujdes edhe më të madhe në kursimin e mjeteve Financiare në kryerjen e shërbimeve të përgjithshme (shpenzimet e karburanteve, telefonit, KEK-ut, Komunalitë, mirëmbajtja e objektit, veturës dhe inventarit) por pa e dëmtuar cilësinë e shërbimeve.				

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

Planifikimi dhe objektivat e përgjithshme të Sektorit për Mbrojtje të Mjedisit:

Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal, 2020-2028.

Zbatimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis, 2020-2028.

Zbatimi i Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit, 2020-2028.

Përgatitja e raporteve për gjendjen e zonave të mbrojtura në Komunën e Glogocit.

Inicimi i procedurave për shpallje zonë e mbrojtur sipas Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës.

Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të tokës, ujit, mjedisit dhe përkrahja e iniciativave në ruajtjen e mjedisit.

Gjelbërimi i hapësirave publike.

Rregullimi i këndit të lodrave për fëmijë.

IV. PROCESI I LEGALIZIMIT

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje dhe miratimin e pesë Udhëzimeve Administrative që dalin nga Ligji Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje trajtohen të gjitha ndërtimet pa leje deri në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit (5 shtator 2018), dhe janë krijuar parakushtet e nevojshme për fillimin e procesit të legalizimit dhe me këtë rast krijohet mundësia e pranimit të aplikacioneve për ndërtimet pa leje.

Për të filluar procesin e legalizimit e ndërtimeve pa leje duhet të bashkëngjitet dokumentacioni i nevojshëm për aplikim siç është:

Shtojca 1- Formulari standard i aplikimit për certifikatë të legalizimit për kategorinë I dhe shtëpitë e kategorisë II (mbi 450 m²).

Shtojca 1A.- Formulari standard i aplikimit për leje të legalizimit për përfundim të ndërtimit për kategorinë I (përveç depove deri 1500 m²) dhe shtëpitë e kategorisë II (mbi 450 m²).

Shtojca 1B.- Deklaratë e pronarit të ndërtimit pa leje.

Shtojca 2.- Formulari standard i aplikimit për certifikatë të legalizimit për kategorinë II (jo shtëpitë).

Shtojca 2A.- Formulari standard i aplikimit për leje të legalizimit për përfundim të ndërtimit kategorinë II (jo shtëpitë).

Shtojca 3.- Formulari standard i aplikimit për lirim nga taksat për legalizimin e ndërtimit pa leje.

4.9. DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Plani i punës për periudhën 1 janar 2020 – 31 dhjetor 2020

Punët kryesore:

Sektori i Gjeodezisë brenda kompetencës lëndore, kryen punët si në vijim:

- Shërbimet e mirëmbajtjes së klasifikimit dhe kulturave të tokës,
- Ndarjen e parcelave,
- Bashkimin e parcelave sipas kërkesës së palëve,
- Përpunimi i skicave të ndarjeve për ndërtesa dhe banesa,
- Rilevimi i sipërfaqes së ndërtesave,
- Përsëritja e kufijve të parcelës,
- Shënimi i kufijve në rastin e eksproprijimit,

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

4.10. DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË

Objektivat	Aktivitetet	Bartësit e aktiviteteve	Afati Kohor	Buxheti (burimet financiare)
1. Shërbimet Publike				
Hartimi i planit buxhetor dhe hartimi i raporteve mujore dhe atyre vjetore të Drejtorisë së DSHPE-së Hartimi i planit të zotimeve dhe shpenzimeve	Hartimi i planit buxhetor për vitin në vijim	Shefat e sektorëve	Gjatë periudhës maj Qershor, ndërsa raportet ditore, javore dhe mujore, permanent gjatë vitit Plani zotimeve në muajin Janar	Buxheti për vitin 2019 i DSHPE-së është : 698,617.20.00€
Hartimi i planit të punës	Hartimi i planit të punës për vitin 2020 Hartimi i raportit vjetor të punës	Drejtori dhe Shefi i sektorit	Gjatë muajit Dhjetor 2019	
Përcjellja e kontratave dhe planeve të menaxhimit, implementimin e projekteve	Implementimi i projekteve në teren	Shefat i sektorit, Menaxheret e projekteve dhe zyrtaret kompetent	Gjatë vitit 2020	Kategoritë: Paga dhe mëditje 177,557,20 € Mallra dhe shërbime 274,365 € Shërbime komunale 55,495 € Shpenzime Kapitale: 181,200 € Subvencione: 10,000 €
Pranimi i kërkesave nga qytetarët. Klasifikimi i kërkesave për sektorët e caktuar brenda DSHPE-se	Pranimi, regjistrimi i kërkesave të adresuara në DSHPE dhe përcjellja e lendeve tek përgjegjësit dhe dhënia e përgjigjeve për palët	Drejtori dhe Shefat e sektorëve	Gjatë vitit	Buxheti i Komunës

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

Menaxhimi i kryerjes së projekteve në përputhje me kontratat në fuqi.	Mbikëqyrja e projekteve nga menaxheret dhe organet mbikëqyrëse, që përfundimi i projekteve të jetë sipas planit dinamik dhe në përputhje me paramasën dhe parallogarinë	Drejtori me stafin	Permanent gjatë vitit	Buxheti i Komunës
Përgjegjësi e zyrtareve në përputhje me kryerjen e punëve në teren me qëllim të reflektimit pozitiv të qytetareve.	Përcjellja e kërkesave dhe zotimi i mjeteve për të gjitha faturat për pagesë për mallra e shërbime dhe shpenzimeve komunale	Drejtori me stafin	Permanent gjatë vitit	Buxheti i Komunës
Menaxhimi dhe mbikëqyrja e projekteve kapitale dhe atyre të mirëmbajtjes	Përcjellja e punimeve në teren dhe përgatitja e raporteve të pranimi për projektet e realizuara në teren dhe kompletimi i lëndëve për procedura të mëtutjeshme për pagës	Shefat e sektorëve dhe menaxheret e projekteve		Buxheti i Komunës
Sektori Emergjencave				
Kërkesat e adresuara në DSHPE përkatësisht sektorit të Emergjencave i klasifikon dhe ju jep prioritetet e duhura sipas gjendjes në teren.	Plotësimi planeve për Vlerësimin e rrezikut dhe Reagimeve Emergjente sipas legjislacionit në fuqi në koordinim me zyrtar nga Agjencia e	Shefat dhe Zyrtaret kompetent	Gjatë vitit	Subvencionet nga DSHPE në vlerë prej 9,000€

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

Koordinimi me akteret kryesor brenda institucionit për situata emergjente në raste të FNFT, dhe Kryetarin e Komunës dhe akteret tjerë të që mund të kontribuojnë në situata të veçanta.	Pranon kërkesat nga tereni për rastet e përfshira nga zjarri, vërshimet dhe FNFT Harton raportet e vlerësimit të dëmeve e të shkaktuara në rastet e FNFT dhe Propozim vendimet për kompensimit e dëmeve nga komuna ose institucionet gjegjëse	Kryetari, Drejtori, Shefat e sektorëve dhe zyrtari për emergjenca Komisioni i vlerësimit të dëmeve	Gjatë tërë vitit	/
Mirëmbajtjen e kanalizimeve, ujësjellësit dhe trajtimi i mbeturinave				
Rritja i cilësisë me furnizimit me ujë për banoret që kanë qasje në rrjetin e ujësjellësit në territorin e Komunës së Drenasit Koordinohet me njësitin e ujësjellësit "KUR", "Prishtina" rreth gjendjes së furnizimit në periudha të ndryshme kohore dhe shkaktaret e ndërprerjes së ujit Mirëmbajtja e kanalizimit atmosferik, fekal dhe gropave septike	Në bashkëpunim me KRU "Prishtina" koordinohen me orarin e reduktimeve dhe bënë publik në vetë faqen zyrtare Përmbushja e kërkesave të qytetarëve në zhbllokimin e kanalizimeve fekale dhe atij atmosferik në qendër të qytetit dhe pastrimi i gropave septike në vendbanime të Komunës	Zyrtari për Ujë dhe Mbeturinave., dhe zyrtari i KUR "Prishtina" Shefi i sektorit dhe zyrtari për UKM	Gjatë vitit Gjatë vitit	Buxheti i Komunës
Mbulushmeria e të gjitha ekonomive familjare me ofrimin e shërbimit të mbeturinave. Koordinimi me të gjitha drejtoritë relevante për	Implementimi i planit për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Drenasit.	Zyrtari për mbeturina në bashkëpunim me shefat, Menaxherin e projektit dhe Kompaninë "Pastrim"	Gjatë vitit	Buxheti i Komunës

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

Punët e Transportit publik				
Menaxhimi i punëve të Transport publik	Rritja e cilësisë në transportin publik të udhëtarëve Caktimin e rrethave të udhëtimit për kompanitë e transportit publik të udhëtarëve dhe respektimi i tyre	Zyrtari për shërbime të transportit lokal.	Janar –Dhjetor 2020	
Menaxhimi me Stacionin e Autobusëve	Mbikëqyrja e punëtorëve në realizimin e detyrave të punës gjatë operimit të kompanive të transportit publik të udhëtarëve	Drejtori, Zyrtari për shërbime të transportit lokal.	Janar –Dhjetor- 2020	
Fillimi i procedurave për krijimin e ndërmarrjes publike- Shoqëri Aksionare me aksione 100% të Komunës.	Dërgimi i propozim vendimit në kuvend për krijimin e ndërmarrjes Publike-SHA, Formimi i bordit të ndërmarrjes Publike, Caktimi i aksionarëve të ndërmarrjes	Kryetari, Kuvendi i Komunës Shefat e sektorëve	Gjatë vitit 2020 Prill -shtator	
Mirëmbajta dhe zgjerimi i vend ndaljeve për	Hartimi i paramasës dhe implementimi i			

PLANI VIETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

Mirëmbajta e rrugëve të rendit të IV, me zhavorr	Caktimi i rrugëve të cilat kanë nevojë për mirëmbajtje të gropave me zhavorr dhe hartimi i raporteve për punët e kryera	Drejtori-Menaxheri i projektit	Mars- Nëntor	
Zgjerimi dhe Mirëmbajta e kamerave në qytetin e Drenasit	Incizimi i gjendjes në teren ku janë të vendosura kamerat, dhe hartimi i para masës lidhur me këtë projekt, dhe fillimi i implementimit të projektit	Shefi sektorit me zyrtarin për ndriçim	Gjatë tërë vitit	
Mirëmbajta tregjeve	Hartimi i paramasës dhe para llogarisë lidhur me këtë projekt dhe implementimi i tij	Shefi i sektorit dhe zyrtari i autorizuar	Gjatë viti 2020	
Bashkëfinancim të projekteve	Do të hartohet paramasat për projektet të cilat do të bashkë financohen nga Komuna dhe donatoret	Shefi i sektorit		
Mbikëqyrja dhe mirëmbajtja e Ndriçimit publik	Hartimi i paramasës dhe para llogarisë për mirëmbajtje të ndriçimit publik dhe implementimi i këtij projekti. Përcjellja e gjendjes në teren dhe hartimi i raporteve lidhur me punët e kryera gjatë mirëmbajtjes së ndriçimit. Hartimi i kërkesave dhe pagesave për faturat e shërbimeve komunale	Menaxheri komunal i energjisë dhe Zyrtari i ndriçimit publik	Janar – Dhjetor	
Mirëmbajtja e sistemit të ENMASOFT lidhur me efqiencën e energjisë dhe bashkëpunimi me Fondin e Mijëvjeçarit për Kosovë	Azhurnimi i të dhënave për shpenzimet e krijuara	Shefi i sektorit	Janar- Qershor dhe Qershor - Dhjetor	

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

Shërbimet e varrimit për qytetarët e Komunës së Drenasit	Hartimi i raportit për pagesa për këtë shërbim.	Menaxheri i autorizuar	Gjatë vitit 2020	
Menaxhimi dhe koordinimi me SHZSH i cili operon vazhdimisht është në shërbim të qytetareve	Përcjell ecurinë e punës të këtij njësi dhe raporton në AME dhe DSHPE	Shefi i sektorit në bashkëpunim me shefin e zjarrfikësve	Gjatë tërë vitit 2020	

4.11. DREJTORIA PËR INFRASTRUKTURË PUBLIKE

Gjatë vitit në vijim do të realizohen projektet si në vijim:

Rregullimi i shtratit të lumit Drenica dhe Vërbica
Ndërtimi i kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza në Komune Drenas
Rregullimi infrastrukturës, trotuareve dhe ndriçim publik Komunën e Drenas
Ndërtimi i infrastrukturës (Asfaltimi dhe Kubzimi)Drenas I,I,III,IV
Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit " Fehmi dhe Xheve Lladrovci Drenas
Infrastruktura në Komoran I,II,III,IV
Ndërtimi i Urave dhe Tombinave dhe mureve Mbrojtëse
Rehabilitimi dhe Rikonstruimi i Rrugëve të Asfaltuara në Drenas
Rehabilitimi dhe Rikonstruimi i Rrjetit të Kanalizimeve në Komunën e Drenasit
Asfaltimi i rrugës në fshatin Gllanasellë - Godanc
Asfaltimi i rrugës në Fshatin Tërstenik I,II dhe Gllobar
Asfaltimi i rrugës në fshatin Poklek i Vjetër, Poklek i Ri, Vasilevë
Infrastruktura në Fshatin Abri e Epërme, Tërdevc
Asfaltimi i rrugës në fshatin Dobroshec, Çikatovë e Vjetër,
Asfaltimi i rrugës në fshatin Baicë, Krajkovë, Damanek Shtrubullovë
Ndërtimi i Infrastrukturës në fshatin Nekoc, Kizharekë
Asfaltimi i rrugës në fshatin Gradicë, Likoshan
Asfaltimi i rrugës në fshatin Arllat, Negroc, Gjergjicë si dhe Bytyq
Asfaltimi i rrugës në fshatin Sankoc, Fushticë e Epërme dhe Fushticë e Ulet
Asfaltimi i rrugës në fshatin Tërdevc - Vuçak
Hartimi i projektit për fizibilitetin e ngrohjes qendrore
Asfaltimi i rrugës në Shtuticë, Vërbovc, Polluzhë
Asfaltimi i rrugës në fshatin Llapushnik, Potërk - Vukovc
Asfaltimi i rrugës në fshatin Zabel i Ulët dhe i Epërm Korroticë e ulet dhe e Epërme

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

Mungesa e veturave zyrtare për monitorim dhe mbikëqyrje të projekteve.

Dhënia dhe shpërblimi për kontraktoret me shume se tri kontrata në të njëjtën kohe për një operator ekonomik si dhe çmimi me i lire ekonomiksht.

4.12. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Gjatë vitit 2020, detyrë e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik është intensifikimi i angazhimeve për përmirësimin e klimës së të bërit biznes dhe promovimin e Komunës se Drenasit si një Komunë atraktive për investitorët strategjik për të investuar dhe për tu vizituar, e hapur ndaj ideve inovative dhe projekteve të reja smart. Andaj punët e Drejtorisë se Zhvillimit Ekonomik gjatë vitit 2020 fokuse të veçantë do t'i kushtoi hartimit dhe realizimit të politikave zhvillimore, marrjen e masave të përshtatshme për të nxitur me tutje zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Komunës se Drenasit:

1. Zhvillimi i politikave dhe dokumenteve Strategjike;

Gjatë vitit 2019 Drejtoria për Zhvillim Ekonomik do ta finalizoj "Strategjinë për Zhvillim Ekonomik 2020-2024, dhe do të përdorët si udhërrëfyes për punët që do realizohen në këtë drejtori por edhe drejtoritë tjera.

2. Rëndësi do t'i kushtohet ofrimit të shërbimeve për regjistrimin bizneseve dhe taksës komunale si detyra të DZHE-së;

- Regjistrimit të bizneseve fillestare (të gjitha bizneset individuale B.I shoqëritë aksionare, ortakëri e përgjithshme, ortakëri e kufizuar, shoqëria e huaj tregtare, ndërmarrjet shoqërore dhe kooperativat bujqësore;
- Regjistrimit të gjitha ndryshimeve në biznes;
- Protokollimi i të gjitha lëndëve që kanë të bëjnë me biznes;
- Raportet javore, mujore pranë MTI;
- Ngarkesa e taksës komunale për biznese;
- Inkasimi i taksës komunale për biznese (pagesat).

3. Vazhdimësia dhe angazhimi në bisedimet rreth funksionalizimit të "Zonës Ekonomik";

Do të vazhdon angazhimi ynë me Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) rreth hapave të mëtutjeshëm të Zonës Ekonomike dhe funksionalizimit të saj.

4. Fokusimi në inovacione;

- Nxitja e zhvillimit ekonomik përmes promovimit të inovacioneve;
- Hulumtimi për qasje në burime të financimit për ide dhe projekte inovative;
- Thirrje për ide dhe projekte inovative;
- Mbështetje e ideve, iniciativave dhe projekteve inovative të të rinjve dhe gruas;

5. Zhvillimi dhe përditësimi i një kalendarit të ngjarjeve të rëndësishme;

Zhvillimi i një Kalendarit Vjetor i cili duhet të përmbajë:

- Panairët;
- Vizitat;
- Konferencat;
- Aktivitetet tjera relevante me ZHEL.

6. Zhvillimi i dokumenteve dhe materialeve të marketingut me qëllim të tërheqjes së investitorëve të jashtëm dhe vendor si dhe tërheqjen e turistëve në destinacionet turistike të Komunës se Drenasit;

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

donatorët dhe ambasadat e huaja dhe institucionet vendore të cilat mbështesin financiarisht zhvillimin ekonomik dhe fuqizimin e Sektorit Privat.

Me qëllim të informimit të shpejtë dhe të drejtë, të dhënat në platformën elektronike do të përditësohen në baza të rregullta.

11. Rritja e bashkëpunimit institucional në mes të Komunës së Drenasit dhe sektorit privat dhe përfshirja e tij në vendimmarrje;

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik synon që brenda këtij viti të avancoj bashkëpunimin edhe më shumë me sektorin privat duke organizuar por jo duke u limituar, takime me përfaqësuesit e bizneseve dhe të diskutoj për sfidat, pengesat, mundësitë dhe planet zhvillimore, takimet vjetore, tryeza informuese.

Me qëllim të komunikimit të lehtë dhe të shpejtë, do të krijojmë një listë të kontakteve për të gjitha bizneset të cilat operojnë në Komunën e Drenasit.

Gjatë këtij viti synojmë të i vizitojmë disa nga bizneset dhe të diskutojmë për së afërmi nevojat dhe mundësitë e këtyre bizneseve.

Biznesi privat do të kyçet drejtpërdrejtë në marrjen e vendimeve dhe aprovimin e dokumenteve strategjike të cilat kanë ndikim në zhvillimin ekonomik.

12. Bashkëpunim i ngushtë me nivelin qendror;

Angazhimi i përbashkët me ministritë relevante rreth gjetjes së mundësive për përkrahjen e projekteve kapitale me qëllim të rritjes së konkurrencës së Komunës së Drenasit për Zhvillim Ekonomik;

Sigurimi i përkrahjes dhe bashkëpunimit nga ministritë relevante rreth hartimit të dokumenteve strategjike dhe operacionale;

Sigurimi i përkrahjes nga ministritë relevante rreth ndërtimit dhe avancimit të raporteve me organizatat vendore dhe ndërkombëtare të cilat mund të ndikojnë në zhvillim ekonomik lokal;

13. Mobilizimi i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik për të hulumtuar dhe përcjellë thirrjet për donacione, grande dhe burime tjera të financimit dhe informimi me kohë i sektorit privat, OSHC-ve, dhe aktorëve tjerë relevant;

- Hulumtim i rregullt në vazhdimësi për grande, donacione dhe burime tjera të financimit;
- Informimi me kohë i sektorit privat dhe aktorëve tjerë për grande dhe donacione;
- Organizimi i sesioneve informuese;

14. Organizimi i konferencës së donatorëve;

- Organizimi i konferencave të donatoreve për dhënien e mundësisë së prezantimit të projekteve të bizneseve lokale;
- Njoftimi i bizneseve lokale për mundësin e promovimit të projekteve të tyre para donatoreve;
- Zhvillimi i materialeve, kopjeve fizike dhe elektronike, me projektet që do të prezantohen në konferencë;

15. Organizimi i konferencës së investitorëve;

Me ndihmën e odave ekonomike ambasadave të huaja në Kosovë dhe ambasadave tona në vendet e jashtme do të ftohen investitorët potencial të jashtëm nga diaspora.

Rritja e bashkëpunimit-koordinimit si: aktereve relevant (Stakeholders) si: MAPL, MTI, MZHE, RDA, dhe AZHR Qendër, EU Office in Kosova, USAID, DEMOS, UNDP, World Bank, Oda Ekonomike Amerikane, Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Ekonomike Gjermane, bizneset lokale, mediat lokale, OSHC-të lokale, Ambasadat, Kompania Rajonale Pastrimi, KEDS, Ujësjiellësi KUR Prishtina etj.

16. Vazhdimi i menaxhimit transparent;


Aplikimi i plotë i transparencës komunale duke publikuar në ueb faqe të Komunës:

- Thirrjet për grande, subvencione;
- Publikimi i raporteve periodike dhe vjetore;

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

- Publikimi i udhëzimeve administrative dhe i rregulloreve të brendshme;
- Publikimi i njoftimeve të ndryshme rreth trajnimeve nga DZHE;
- Publikimi i thirrjeve për dëgjime publike dhe konsultime me kohë në ueb faqe të Komunës;

KRYETARI I KOMUNËS
RAMIZ ILADROVCI





**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës**

Nr. 12.052-3490 dt. 21.01 2020



**Raporti i Komitetit për Arsim Kulturë Rini dhe Sport drejtuar
asamblesë së Komunës së Drenasit**

Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport në vitin 2019 ka mbajtur tri mbledhje:

1. Zgjedhja e kryetarit dhe nënkryetarit.
2. Mbledhje me Drejtorin e DKA-së.
3. Mbledhja me Drejtoreshën e DKRS-së

Me date 19.08.2019 në mbledhjen e Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport. Kryetar u zgjodh Gentrit Mulaku, dhe nënkryetare Resmije Krasniqi, përveç zgjedhjes së kryesisë anëtarët e komitetit diskutuan për problematikat dhe sfidat që do të ballafaqohen si anëtar të KKKAKRS.



Me datë 25.10.2019 Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport patën një konsultim me drejtorin e Drejtorisë për Arsim në komunën e Drenasit z. Tafil Halilaj, ku përveç tjerash diskutuam edhe për çështjet në vijim:

1. Ndarja e orëve dhe ndarja e normativit
2. Pushimet pa pagesë
3. Konkursët të rregullta dhe plotësues
4. Shpallja e vendeve të lira të punës
5. Profilet e shkollës profesionale
6. Hartimin e rregullores për shkolla



Komitetit për Arsim Kulturë Rini dhe Sport më dt. 06.12.2019, ka mbajtur mbledhjen konsultative me drejtoreshën Shqipe Zogu, drejtoresha e DKRS-së, ndër të tjera diskutuan në këto pika:

1. Buxheti i DKRS-së për vitin 2020 (ndarja e buxhetit për sektorët Kulturë, Rini dhe Sport)
2. Ndarja e subvencioneve nga DKRS (koha më e përshtatshme për ndarjen e subvencioneve për vitin 2020)
3. Mundësia për riaktivizimin e festivaleve, të cilat janë organizuar tradicionalisht në Komunën e Drenasit, siç janë "Revista Burimore e Folklorit", "Ditët e Humorit", etj.
4. Ligjit për Ansamblin e Qytetit, mundësia e implementimit të këtij ligji në Komunën e Drenasit
5. Ligji për teatrot, mundësia e implementimit të këtij ligji në Komunën e Drenasit
6. Planet për ndërtimin e godinës së Muzetë, Kinemasë dhe Teatrit në qytetin e Drenasit
7. Skena Profesionale për aktivitete të ndryshme kulturore-artistike si dhe zërmi profesional
8. Dekorimi i qytetit për fundvit si dhe planet për organizimin e aktiviteteve kulturore-artistike





Republlika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Komiteti Konsultativ për mbrojtje të Ambientit Zhvillim
Ekonomik, shëndetesi dhe Mirëqenie sociale



Nr. 12.052-3505 dt. 24.01 2020

RAPORT I KONSTITUIMIT

2019

Drenas 2020

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Takimi I parë.....	4
Takimi I dytë.....	5
Takimi I tretë.....	6
Konkludime.....	7

Hyrje

Procedura e themelimit, organizimi dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna është dhënë nga Udhëzimi Administrativ I Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me Nr.01/2016.

Qëllimi I këtij udhëzimi administrative është që përmes komiteteve konsultative në komuna të krijoj mundësinë për pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe grupev tjera të interes, në procesin e vendimmarrjes për interes public.

Komitetet konsultative janë trupa ndihmës të kuvendit të komunës, roli I të cilave është që përmes këtyre komiteteve të jenë më transparente, më efikase dhe të japin më shumë llogari qytetarëve.

Në komën e Drenasit aktualisht veprojnë katër Komitete konsultative.

Komiteti Konsultativ për zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është formuar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Drenasit të mbajtur me 26.09.2019.

Me këtë vendim po ashtu është aprovuar edhe lista e anëtarëve të këtij komiteti në përbërje prej pesë (5) anëtarëve si vijon:

1. Fitore Sefiu-Shabani
2. Burim Dvorani
3. Arbresha Haziri
4. Violeta Ipshi-Bujupi
5. Basri Gashani

Mandati I komitetit konsultativ nga themelimi dhe aprovimi në Kuvend është katër (4) vjeçar

ORGANIZIMI I PUNËS

Takimi I parë

Mbledhja e parë e Komiteti Konsultativ për zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është mbajtur me 09.10.2019.

Temat e trajtuara ishin: Zgjedha e kryesuesit të Komitetit, Zgjedhja e zëvendës kryesuesit si dhe diskutimi rreth Udhëzimit Administrativ, funksionimit dhe kompetencave të Komiteteve Konsultative.

Kryesues I Komiteti Konsultativ për zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është zgjedhur Fitore Sefiu-Shabani, ndërsa zëvendës kryesues është zgjedhur Burim Dvorani.



Fig.1. Përbërja e komitetit

Takimi I dytë

Takimi I dytë është mbajtur me 26.11.2019. Në këtë takim kemi shqyrtuar një kërkesë të banorëve të komunës së Drenasit më konkretisht të objektit banesorë "Altrade Holding" e cila gjendet në rrugën Bedri Shala. Sic thuhet nga banorët në hyrje të ndërtesës janë vendosur dy kontenjer të mbeturinave të cilat bëjnë pengse për banorët në hyrje-dalje të ndërtesës si dhe nga kundërmimet e mbeturinave. Problemi në fjalë është drejtuar drejtorisë përkatëse përkatësisht Drejtorisë për Emergjencë.

Po ashtu takuam edhe me drejtoreshën për Zhvillim Ekonomik me znj. Egzona Jetullahu.

Takimi ishte më tepër një takim njoftues duke shqyrtuar edhe mundësitë e bashkepunimit në të ardhmen.

Takimi I tretë

Mbledhja e tretë e Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik ,Mbrojtje të Ambientit , Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS) , u mbajt më 06.12.2019.

Ndër të tjerat që u diskutuan ishin edhe takimi me drejtoreshën e Shërbimeve Publike dhe Emergjencia znj.Lumnije Krap. Në këtë takim u konsultuam për problemet e qytetarëve të komunës së Drenasit në fushat të ndryshme si me ujë të pijshëm, ndotje të ambientit nga qytetarët e pandërgjegjshëm nga mbeturinat dhe ujrat e zeza.



Fig.2.takimi me drejtoreshën znj.Lumnije Krap

Poashtu takuam edhe kryesuesin e Kuvendit Komunal të Drenasit z.Labinot Halilaj.Takimi me z.Halilaj ishte një takim formal njohës si dhe informues rreth Kuvendit.



Fig.3.Takimi me z.Labinot Halilaj

Konkludime

Megjthë faktin që ne si komitet jemi formuar në fund të vitit 2019, me përkushtimin tonë si komitet dhe me ndihmën e zyrtarëve të drejtorivë të Komunës së Drenasit, kemi arritur një bashkëpunim duke u munduar t'u dalim në ndihmë qytetarëve tonë.

Besojmë dhe shpresojmë se së bashku do të arrijmë të jemi një urë bashkëpunuese në mes qytetarëve dhe shërbyesve komunal.

Kryesuese KKZHEMASHMS

Fitore Sefiu-Shaban



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Të dhëna			
21.01		2020	
Org.	Numër	Shtojca	Vlera
12	052	3498	



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Gllogocit)



R A P O R T

MBI PUNËN E KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË KOMUNËN E DRENASIT PËR VITIN 2019

(I)

PJESA HYRËSE

Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, në komunën e Drenasit, është themeluar në muajin shtator 2019, dhe përbëhet prej pesë anëtarëve, njohës të mirë të aftësive të kufizuara. Ky komitet, në përbërje prej katër anëtarëve, është përzgjedhur sipas konkursit nga Paneli Intervistues i Kuvendit Komunal të Drenasit, dhe si i tillë organizon mbledhje formale dhe jo formale, përmes të cilave priorizon aktivitete për PAK. Mbledhjet formale, zakonisht ky komitet i mbanë në zyrën pranë byfësë në Komunën e Drenasit, kurse mbledhjet jo formale dhe takimet tjera konsultative i zhvillon në terren dhe sipas rastit.

Me qëllim të transparencës, ky Komitet ka përmbledhur një raport me qëllim të informimit të komunitetit të aftësisë së kufizuar, si dhe të institucioneve komunale për punën dhe aktivitetet tona si Komitet Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (KKPAK), përgjatë periudhës Shtator-Dhjetor 2019. Duke qenë transparent dhe duke iu përmbajtur kontinuitetit në raportim, Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara i Komunës së Drenasit, publikon këtë raport për të përmbledhur punën, aktivitetet dhe mbledhjet e realizuara.

Ky organ drejtues i ri institucional, i formuar për herë të parë në komunën e Drenasit i cili vepron në harmoni me “Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2016, për Procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komitetetve Konsultative në Komuna”, përmes mbledhjeve të realizuara ka shqyrtuar dhe diskutuar në hollësi detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit dhe të secilit anëtar veç e veç. Specifikisht, si qëllime dhe detyra prioritare të këtij komiteti janë vënë: nxitja, mbrojtja dhe sigurimi i mundësisë që të gjithë Personat me Aftësi të Kufizuara në territorin e Komunës së Drenasit t’i gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre, sa u përket specifikave të këtyre personave dhe domenit të nivelit komunal të qeverisjes, e kjo gjithnjë në bashkëpunim të përhershëm me institucionet komunale, me OJQ-të e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe me vet Personat me Aftësi të Kufizuara.

Përveq mbledhjeve formale, ky komitet ka mbajtur edhe takime të tjera jo formale - konsultative, përmes të cilave janë konkretizuar ide dhe specifika në aspektin e përmirësimit të gjendjes së Personave me Aftësi të Kufizuara - PAK në komunën e Drenasit. Me anë të zhvillimit të këtyre kontakteve me institucione dhe me individë, ne si Komitet për PAK kemi konsideruar se mund të jenë aleatë të orientimeve të tija për të drejtat dhe mundësitë e këtyre personave.

Gjithashtu, Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara së bashku me institucionet komunale dhe me Organizatat Jo qeveritare u dakorduan të fillojnë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e Aftësisë së Kufizuar, bashkëpunim ky i cili do të jetë në shërbim të PAK, sepse ndryshe, mungesa e bashkëpunimit pasqyron jo dobi në shërbim të këtyre personave.

Përgjithësisht, në periudhën raportuese dhe sipas rregullativës së Kuvendit Komunal të Drenasit, Komiteti ka mbajtur katër (4) mbledhje të rregullta, gjithashtu ka lidhur kontakte përmes email-it dhe ka mbajtur më se shtatë (7) takime konsultative me si anëtarë por edhe me përgjegjësit digasterialë të drejtorive komunale, OJQ etj.

(II)

PJESA TEMATIKE

MBLEDHJET

Mbledhja e parë e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara (11.07.2019)

Me datë 11.07.2019 u mbajtë mbledhja e parë e Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në sallën e Kuvendit Komunal të Drenasit. Kjo mbledhje në fakt është realizuar pas përzgjedhjes sonë si anëtarë, por ende pa u proceduar komiteti në mbledhjen e asamblesë komunale. Mbledhja e KKPAK, filloi në orën 13:00, dhe procesverbali është mbajtur nga njëra ndër anëtarët e zgjedhura të këtij komiteti-Ariana Isufi. Të pranishëm në këtë mbledhje ishin pesë anëtarët e zgjedhur të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara: Ariana Isufi, Arlindë Krasniqi, Burim Fazliu, Jehona Abdyli dhe Shemsi Bërbatovci.

Pasi u konstatua se në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët, u propozua rendi i ditës.

Rend dite kishim:

1. Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara
2. Zgjedhja e zëvendës kryesuesit të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara
3. Të ndryshme

Lidhur me pikën e parë të rendit të ditës kemi diskutuar për zgjedhjen e kryesuesit të këtij komiteti. Njëri nga anëtarët e këtij komiteti, përkatësisht Burim Fazliu, ka propozuar për kryesues Shemsi Bërbatovci, i cili unanimisht është zgjedhur si kryesues me votat e të gjithë anëtarëve të tjerë.

Lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës, Jehona Abdyli ka propozuar që për zëvendës kryesues të zgjedhet Ariana Isufi, e cila po ashtu është zgjedhur unanimisht me votat e të gjithë anëtarëve. Pas votimit njëzëri të këtyre dy propozimeve, është kaluar në pikën e radhës.

Në pikën e tretë të rendit të ditës, diskutuam mbi Udhëzimin Administrativ në harmoni me të cilin veprojmë ne si komitet, për planifikimin e detyrave dhe obligimeve që kemi.

Me kaq mbledhja e datës 11.07.2019 mori fund në orën 14:20.

Mbledhja e dytë e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara (11.10.2019)

Pjesëmarrës në këtë mbledhje ishin pesë anëtarët e zgjedhur të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara: Shemsi Bërbatovci- kryesues i Komitetit, Ariana Isufi- zëvendës kryesues, Arlindë Krasniqi- anëtare, Burim Fazliu- anëtar, dhe Jehona Abdylë – anëtare. Nga ky takim, ne kemi diskutuar në lidhje me këto pika:

1. Propozimi për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësiave mes anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, lidhur me aktivitetet që do të realizohen deri në mbledhjen e radhës.
2. Planifikimi dhe shqyrtimi i mundësive për daljen në terren, në vizita për PAK.
3. Planifikimi për takim dhe bashkëpunim me Organizatën “Handikos” në Drenas dhe shkëmbim përvojash.

Lidhur me këto pika të rendit të ditës, komiteti në fjalë ka propozuar të identifikohet dhe hulumtohet më shumë mbi gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat më të afërta të rregullta. Diskutimin e kemi vazhduar duke rekomanduar marrjen e më shumë informatave në aspektin infrastrukturor në komunën e Drenasit si dhe kemi ngritur si çështje shërbimet shëndetësore që u ofrohen PAK, në institucionet private dhe ato publike.

Mbledhja e tretë e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara (11.11.2019)

Në mbledhjen e tretë, kemi nxjerrur diskutimet si më poshtë:

1. Gjetja e mundësive për bashkëpunim me Handikos/ Shoqata të tjera në Drenas, lidhur me konkretizimin e iniciativave të përbashkëta për Personat me Aftësi të Kufizuara.
2. Bashkëpunimi me DKA në Drenas lidhur me identifikimin e numrit të nxënësve me Aftësi të Kufizuara në shkolla si dhe diskutimin për asistentët ekzistues më këta fëmijë/nxënës, dhe diskutim për mundësitë ligjore dhe buxhetore në këtë drejtim

Bazuar në pikat e ngritura për rend dite, perkitazi me aktivitetet e planifikuara është rekomanduar formimi i trekëndëshit të bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse për PAK, si dhe shërbimet e domosdoshme që ju ofrohen aktualisht, dhe çka duhet të u ofrohet kësaj kategorie.

Perkitazi me pikat e ngritura të rendit të ditës dhe nga takimet që kemi realizuar me Handikos, në kemi shkëmbyer një varg ideshë lidhur me hapat që do të marrim për të përmbushur objektivat tona të përbashkëta, që më së shumti do t'i kontribuojnë PAK.

Përgjatë takimit me Handikos në zyret e tyre, ne kemi diskutuar së bashku me menaxherin e Handikos z. Behxhet Binaku dhe stafin e tij edhe në lidhje me Planin e Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara, me ç'rast Handikos ka punuar një dokument të tillë, të formalizuar për vitin 2018, së bashku me ekipen punues, duke përfshirë kështu në mënyrë të detajizuar të drejtat e PAK, dhe çështjet me prioritet për këta persona, në fushat: Arsim, Mirëqenie sociale, Shëndetësi, Punësim, Mbrojtje ligjore, Qasje informim, Komunikim, Pjesëmarrje dhe Statistika, mirëpo ky dokument nuk ju është aprovuar nga asëambleja komunale. Megjithëse, ne do të punojmë në këtë drejtim, dhe në këtë Plan të Veprimit do të jenë të përcaktuara aktivitetet, treguesit, mjetet e verifikimit, synimet e secilit aktivitet, afatin kohor të realizimit si dhe koston financiare të përlogaritur për secilin aktivitet, në të gjitha fushat e përmendura nga lartë.

Mbledhja e katërt e Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (23.12.2019)

Përgjatë mbledhjes së katërt dhe të fundit për vitin 2019, kemi reflektuar në pikat e rendit të ditës së mbledhjes së kaluar, dhe kemi diskutuar për mundësitë për realizimin e tyre, sfidat dhe rezultatet e arritura. Të pranishëm në mbledhje ishin pesë anëtarët e këtij komiteti, përkatësisht: Ariana Isufi, Arlindë Krasniqi, Jehona Abdyli, Shemsi Bërbatovci dhe Burim Fazliu,

Pas këtij diskutimi, pjesa e dytë e takimit ju është përmbajtur pikave të rendit të ditës, të cilat ishin:

1. Parashtrimi i kërkesës në Qendrën për Punë Sociale (QPS), për një takim konsultativ lidhur me qasjen në informata për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK), në Qendrën e tyre.
2. Parashtrimi i kërkesës në DKA për vizitë në shkollat ku kanë fëmijë/ nxënës me Aftësi të Kufizuara.
3. Te ndryshme – kemi diskutuar në lidhje me Raportimin e aktiviteteve që i kemi realizuar në periudhën Shtator – Dhjetor 2019.
- Megjithëse, kishte propozime nga anëtarët e Komitetit për orarin e mbajtjes së mbledhjeve, me ç'rast unanimisht grupi vendosëm që mbledhjet të realizohen ditëve të premte në vendin e zakonshëm, përkatësisht në zyrën pranë byfese në komunën e Drenasit.

Bazuar në aktivitetet e planifikuara, ne si Komitet Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në komunën e Drenasit, në bashkëpunim me OJQ dhe Drejtoritë komunale që kontribuojnë në aspektin e përmirësimit të gjendjes së Personave me Aftësi të Kufizuara, kemi vlerësuar të dobishme përpjekjet për të punuar në drejtim të hartimit të Planit të Veprimit 2020-2022 për Persona me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Drenasit. Kjo iniciativë dhe të tjera, rrjedhin si rezultat i identifikimit të problematikave me të cilat ballafaqohen Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK) në komunën tonë.

Siç kemi identifikuar, realiteti aktual për PAK, është ende larg realizimit të të drejtave të tyre, sepse ata janë grupi më i marginalizuar i shoqërisë, të cilët nuk mund t'i realizojnë të drejtat e veta ligjore dhe më elementare, qoftë në lidhje me shërbimet shëndetësore, arsim, qasje jo e duhur ndaj personave me aftësi të kufizuara në shërbimet administrative dhe më gjerë, madje përfshirë edhe të drejtën për punësim, ku dihet se ligjshmërisht, çdo i pesëdhjeti i punësuar duhet të jetë PAK, ose 2% e të punësuarve.

Burimet e raportit përmblendës të aktiviteteve të realizuara për vitin 2019 janë ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjeve/takimeve të Komitetit. Raporti, pas miratimit në mbledhje të Komitetit, do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komunës së Drenasit.

- ❖ Pa dyshim që gjatë punës sonë për vitin 2019 kemi nxjerrur rezultate konkrete me anë të aktiviteteve dhe angazhimit tonë, por gjithashtu kemi hasur edhe në kufizime apo barriera të lehta të cilat kanë pamundësuar realizimin e disa aktiviteteve në kohën e planifikuar.

Rezultatet

- Kemi lidhur bashkëpunim të ngushtë me HANDIKOS në Drenas, dhe me anë të partneritetit të krijuar kemi identifikuar aktivitetet që realizon kjo OJQ, çfarë është sfida për ta, dhe çfarë është e nevojshme që ata të vazhdojnë të kontribuojnë për PAK.
- Ngushtësisht jemi në kontakte të vazhdueshme me drejtorë dhe mësimdhënës shkollash të komunës së Drenasit, të cilët ofrojnë shërbimet e nevojshme për fëmijët me Aftësi të Kufizuara.

Kufizimet

- Mos realizim i takimeve me më shumë drejtorë dhe zyrtarë të institucioneve komunale, si p.sh. takime me drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport, në mënyrë që të nxirren rekomandime të përbashkëta për të shiquar mundësitë për PAK, për aktivitet kreative, zhvillimin e ndonjë loje nga PAK etj.
- Mos realizimi i vizitave në shkollat ku fëmijë me aftësi të kufizuara frekuentojnë mësimin, identifikimi i saktë për të gjitha shkollat e komunës së Drenasit në lidhje me mësuesit mbështetës dhe asistentët që u ofrojnë shërbimet e nevojshme nxënësve me aftësi të kufizuara në këto shkolla, e gjitha kjo si rezultat i neglizhimit të bashkëpunimit nga zyrtarë kompetent nga DKA për sigurimin e këtyre informatave.

Disa nga propozimet për vitin 2020:

- Bashkëpunimi me OJQ dhe drejtoritë komunale, në aspektin e hartimit të një dokumenti siç është Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara për periudhën 2020-2023
- Realizimi i takimeve me zyrtarë dhe donatorë për të rikujtuar iniciativat p.sh. për rritjen e numrit të asistentëve, meqë është miratuar Ligji.
- Përpjekje në gjetjen e mënyrave për të ndikuar në përmirësimin e infrastrukturës dhe rregullimit të pjerrinave në ato hapësira ku PAK kanë qasje dhe detyrimisht duhet të marrin shërbimet e nevojshme.
- Takime të rregullta me kryetarin e komunës së Drenasit, si dhe me përfaqësues të tjerë nga Kuvendi Komunal, për të shkëmbyer ide dhe përvoja në këtë fushë.

(III) PJESA PËRMBYLLËSE

KONKLuzionet me Rekomandime

Përgjatë periudhës së ardhshme për tre vite, të funksionimit të Komitetit dhe sipas këtij raporti mund të konstatohet se problemet e PAK në Komunën e Drenasit janë të shumta, me theks të veçantë, në punësim, temë kjo e cila i prekë më së shumti PAK. Megjithatë, Komiteti njeh një gatishmëri më të madhe të institucioneve komunale të Drenasit për t'i përmbushur obligimet ligjore për PAK, por thirren në kufizimet ligjore dhe buxhetore në realizimin e të drejtave të PAK, veçmas në sferën e punësimit.

Mbështetur edhe në të cekurat e raportit, Komiteti nxjerr këto rekomandime:

- ♦ Definimi i prioriteteve dhe masave të nevojshme që duhet të ndërmerret nga Kuvendi i Komunës dhe Shoqëria Civile për përmirësimin e situatës së tanishme në lidhje me personat me aftësi të kufizuara në secilin sektorë.
- ♦ Komiteti Konsultativ të propozoj dhe ndihmoj drejtoritë përkatëse për hartimin e rregulloreve komunale, në pajtim me ligjet në fuqi në fushën e Aftësisë së Kufizuar.
- ♦ Punëdhënësit në nivelin lokal të jenë fokusi primar i avokimit për zbatim të kornizës ligjore për punësimin e PAK, e cila kornizë përcakton qart formën dhe mundësinë për punësimin e tyre.
- ♦ Të promovohen lehtësirat ndaj kontraktorëve biznesorë që kanë apo zotohen të punësojnë PAK, sipas legjislacionit dhe Planit të veprimit 2020-2023, për PAK në Komunën e Drenasit.
- ♦ Anëtarët e Komitetit ta rrisin ndikimin e tyre te zyrtarët komunalë për punësim më të madh të PAK dhe për sigurimin e të drejtave të barabarta sociale.

Anëtarët e Komitetit për Personat me Aftësi të Kufizuara në Drenas:

1. Shemi Bërbatovci – kryesues
2. Ariana Isufi – zëvendës kryesues
3. Arlindë Krasniqi – anëtare
4. Burim Fazliu – anëtar
5. Jehona Abdyli - anëtare





REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
ZVRA E KRYETARIT



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLLOGOC GLLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar 17.01 2020			
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	052	3197	

RAPORTI FINANCIAR
I Zhvillimit Të Buxhetit Janar - Dhjetor 2019

JANAR 2020

Baza për Raportim

Në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP-së) përkatësisht neni 45.4, kryetari i komunës duhet të përgatit dhe t'i dorëzojë kuvendit komunal raporte periodike të cilat mbulojnë vitin fiskal deri në fund të vitit i cili sa po ka përfunduar. Këto raporte duhet t'i dorëzohen kuvendit komunal dhe një kopje ministrit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të çdo periode, dhe më pasë duhet të publikohen në faqën e internetit të komunës.

Qëllimi i këtij raporti është që të njoftoi Bordin e Drejtorve, Komitetin për Politikë dhe Financa, Kuvendin Komunal, të gjitha mediet (elektronike dhe të shkruara) si dhe qytetarët për realizimin e buxhetit komunal për periudhën raportuese janar-Dhjetor 2019. Buxheti komunal për periudhën janar-Dhjetor 2019 nënkupton Ligjin .06/L-133 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Deri sa buxheti paraqet qëllimet e performancës, raporti paraqet masën deri në të cilën qëllimet e performancës janë arritë, duke përfshirë vlerësimin kuantitativ dhe kualitativ të rezultateve. Ky raport gjithashtu paraqet edhe krahasime me periudhën e njëjtë të një viti më parë. Në këtë raport paraqitet mënyra e realizimit të buxhetit për nga karakteri ekonomik në pesë kategori kryesore ekonomike të shpënzimit; ndërsa për nga karakteri funksional në njëzetë (20) programe -nënprograme buxhetore.

Të dhënat e raportit për shpenzimet operative (Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shpenzime të Shërbimeve Komunale dhe Subvencio) dhe Shpenzime të Investimeve Kapitale, janë në harmoni me Departamentin e Thesarit pranë Ministrisë për Financa, ndërsa të dhënat për numrin e punëtorve dhe shumat për shpenzimet e Pagave dhe Mëditjeve me Shërbimin e përllogaritjes së pagave Ministrin e Administratës Publike.

Përgatitja e raportit është bërë në pajtim me Ligjin e Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësit 03/L-048, të ndryshuar me Ligjin 04/L-221, dhe Standardet Ndërkombtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) bazuar në para të gatshme-raportimi financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Në raport vërehet se programet - nënprogramet rëndësi të veçantë kanë dhënë shpenzimet të mjeteve të financuara nga Grantet Qeveritare si burim kryesor i të hyrave, pasi të hyrat nga burimet vetanake janë në disponim për shpenzim pa ndonjë shkurtim eventual nga Qeveria. Zyra e Kryetarit gjatë përgatitjes së këtij raporti s' bashku me Drejtoratin për Buxhet dhe Financa është munduar me përkushtimin më të madh që me detaje dhe saktësi të paraqes realizimin-zhvillimin e buxhetit komunal për periudhën raportuese, gjegjësisht janar-Dhjetor/019. Valuta raportuese është Euro (€).

Ne mirëpresim çdo koment që do të kontribonte pozitivisht në përmirësimin e raporteve të ardhshme.
Tabela Nr.1 Buxheti Komunal sipas Ligjit Nr.06/L-133 për Buxhetin e Republikës së Kosovës /2019, shprehur në euro.

Tab.nr.1

Përshkrimi	Buxheti	Pagat	Mallra e shërb.	Shpenz.Kom.	Subv.e transf.	In.Kapitale	Nr.punt
Z.Kryetari	187,939.00	140,339.00	42,600.00	-	5,000.00	-	16
Adm.person	432,992.00	221,372.00	132,120.00	1,500.00	1,000.00	77,000.00	41
Inspektorati	98,338.00	62,438.00	35,900.00	-	-	-	9
Z.Kuvendit	132,020.00	108,920.00	23,100.00	-	-	-	-
Buxhet dhe finan.	114,582.00	97,032.00	17,550.00	-	-	-	15
Shërb Pub. Em.	771,467.00	154,511.00	262,550.00	52,000.00	9,000.00	293,406.00	24
Infrastruktur Publik	3,100,556.00	47,423.00	22,450.00	-	-	3,030,683.00	8
Z.K.Kthim	8,999.00	7,963.00	1,036.00	-	-	-	1
Bujqësia	126,230.00	65,530.00	10,700.00	-	50,000.00	-	10
Janif.dhe Zhvill.Ekor	77,206.00	42,906.00	34,300.00	-	-	-	6
Gjeodezi dhe Kad.	142,920.00	77,810.00	5,110.00	-	-	60,000.00	12
Urbanizmi	146,649.00	47,199.00	17,450.00	-	-	82,000.00	7
Administrata Sh.	119,865.00	35,778.00	57,740.00	-	26,347.00	-	5
Kujd.Prim.Shënd	1,953,895.00	1,211,645.00	342,850.00	44,400.00	-	355,000.00	181
Shërb Sociale	99,113.00	77,713.00	15,680.00	5,720.00	-	-	14
Kultura dhe sporti	388,401.00	66,081.00	47,320.00	-	60,000.00	215,000.00	11
Adm. Arsimit	901,995.00	75,833.00	253,956.00	-	80,000.00	492,206.00	11
Ars.Parafillor	168,005.00	117,525.00	44,480.00	6,000.00	-	-	22
Ars. Fillor	4,849,658.00	4,505,970.00	276,894.00	60,493.00	-	6,301.00	757
Ars. I Mesem	1,350,772.00	1,259,517.00	72,255.00	19,000.00	-	-	175
	15,171,602.00	8,423,505.00	1,716,041.00	189,113.00	231,347.00	4,611,596.00	1325

Deri sa tabela e lartë shënuar paraqet buxhetin-planifikimin e të hyrave dhe të dalave-shpenzimeve, tabelat në vazhdim të raportit paraqesin zhvillimin e buxhetit, po ashtu për të hyra dhe të dala për periudhën raportuese.

Realizimi i të hyrave vetanake për periudhën Janar - Dhjetor 2019 dhe krahasimi i tyre me një vit më parë.

Tabela nr.2


Nr.rend	Muaji	Plani 2019	Realizimi 2019	Real.Vitit 2018	% me plan	Krahasimi me 2018%
1	Janar	109,461.25	63,385.74	71,596.91	57.91	88.53
2	Shkurt	109,461.25	62,163.01	95,365.60	56.79	65.18
3	Mars	109,461.25	68,044.30	99,959.07	62.16	68.07
4	Prill	109,461.25	326,539.03	59,827.81	298.31	545.80
5	Maj	109,461.25	99,535.75	137,075.48	90.93	72.61
6	Qershor	109,461.25	120,062.87	382,727.51	109.69	31.37
7	Korrik	109,461.25	108,191.70	86,702.82	98.84	124.78
8	Gusht	109,461.25	114,872.24	92,550.70	104.94	124.12
9	Shtator	109,461.25	85,552.07	62,206.55	78.16	137.53
10	Tetor	109,461.25	151,681.97	53,241.48	138.57	284.89
11	Nëntor	109,461.25	75,750.37	68,562.47	69.20	110.48
12	Dhjetor	109,461.25	102,306.47	100,705.80	93.46	101.59
	Totali	1,313,535.00	1,378,085.52	1,310,522.20	104.91	105.16

Vërejtje :Shenime nga raporti i free balance të datës 08.01.2020 pa gjoba trafiku dhe gjykatav.

Ndërsa nese ja shtojmë dhe gjobat e gjykatav dhe trafikut të cilat janë të planifikuara si të hyra shuma arrin në: 1,839,900.02 €

Tabela Nr.2, paraqet të dhënat lidhur me arkëtimin e të hyrave nga burimet vetanake për periudhën janar- Dhjetor të vitit fiskal 2019, të krahasuara me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Krahasuar me planifikimin (1,313,535 €) të hyrat nga burimet vetanake janë realizuar 104.91%, ndërsa në raport me periudhën e njëjtë të një vitit më parë kemi renje të performancës për + 0.24%, në këtë raport nuk janë paraqitur të hyrat indirekte nga gjykatat dhe gjobat e komunikacionit (461,814.50) edhe pse në planifikim marrin pjesë.

Paraqitja grafike e planifikimit të të hyrave dhe realizimit për periudhën Janar - Shtator të vitit 2019.



Pasi që më lartë është bërë shpalosja e të hyrave vetanake të planifikuara e të realizuara, duke u krahasuar me vitin paraprak, kurë është fjala te Grantet Qeveritare planifikimi vjetor është i paraparë të jetë në shumë prej: 13,701,841.00€, nga kjo del periudha raportuese do të jetë në shumë prej:13,701,841.00 €, ndërsa është ndarë shuma prej:13,701,841.00 €,

Të dhënat e raportit të Sistemit Informativ të Menaxhimit Financiar tregojnë se ndarjet nga Grantet janar-Dhjetor paraqesin shumën prej: 13,701,841.00€, krahasuar me planifikimin kemi ndarje sipas planifikimit.

Shikuar ndarjet Alokimet) e Granteve (13,701,841.00 €) për nga karakteri i shpenzimeve, shpenzimet operative (P&M, M&Sh,Sh.Sh.K) marrin pjesë në shumë prej :10,113,334.00 €, apo 73.81 %; kurse Sh.Kapitale me shumën prej:3,553,760.00€, apo 25.94 %,Subvencionet me 0.20% Në periudhën janar-Dhjetor/019, (Alokimi) pranimit-të hyrat për nga burimet e financimit janë realizuar si vijon:

* Grantet Qeveritare (Burimi i financimit 10) = 13,701,841.00 €,

*Të Hyrat nga Burimet Vetanake 2019 (Burimi i financimit 21) = 1,378,085.52 €, + (461,814.50 gjoba komunikacioni dhe gjykatav)

*Të Hyrat nga Burimet Vetanake 2018 (Burimi i financimit 22) = 811,638.32 €, dhe

*Donacionet (Burimi i financimit 31) =24,903.97 €.

* Grande për performanc (59-61) =247,439.00 €

* Të hyrat nga Huaja (04) = 40,760.80 €

Gjithsejt pranimet 16,140,118.12

Zhvillimi i buxhetit komunal për periudhën Janar-Dhjetor 2019 lidhur me të dalat-shpenzimet

Dihet se komuna shpenzimet i menaxhon përmes llogarisë së vetme të Thesarit (LVTH) e cila mbulohet nga Autoriteti Bankar i Kosovës (AQBK) më këtë Nr.1000650070000022.

Procesi i shpenzimeve është i përfshirë në disa koncepte kryesore (Ndarje teknike) lidhur me shpenzimin e parave publike, së pari kemi të bëjmë me delegimin e përgjegjësisë nga Zyrtari Kryesor Administrativ të menaxherët e programev-nënprogrameve, njëherit mbajtës të buxheteve, procesë ky si çdo vit edhe në këtë, është bërë në janar/019 nga ana e Kryetarit të Komunës, proces i cili ngrit transparencën dhe performancën, krahas përgjegjësisë. Në vijim kemi edhe këto ndarje teknike - koncepte kryesore:

- * Ndarja buxhetore ,
- * Akordimi i fondeve ,
- * Zotimi i fondeve ,
- * Inicimi i shpenzimeve ,
- * Prokurimi,
- * Pranimi i mallërave - shërbimeve ,
- * Pagesa e faturave dhe
- * Lëshimi i fondeve nga llogarija bankare.

Për të arritur qëllimet e një performance sa më të mirë në drejtim të shfrytëzimit të parasë publike (Vlera për parane) me kohë në janar të këtij viti është përgatitur Plani i zotimit dhe shpenzimit të parasë së gatshme sipas periodave të vitit 2019 dhe është dorëzuar në Departamentin e Thesarit-M.F si para kushtë i ndarjes së mjeteve. Për këtë periudë mjetet financiare janë akorduar sipas planit , Pagat dhe Mëditjet një e dymbdhjeta e buxhetit për muaj; ndërsa për kategorit tjera ekonomike të shpenzimeve sipas planit.

Në tabelat vijuse është bërë paraqitja e zhvillimit të buxhetit si për nga karakteri ekonomik, e poashtu edhe funksional i planifikimit dhe shpenzimit.

Realizimi - shpenzimi i buxhetit komunal sipas Programëve-nënprogrameve për periudhën Janar -Dhjetor 2019

Zyra e Kryetarit

Tab.3

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	% e reali. alokim	% me buxhet Qert	Buxheti vjetor
1	Pagat dhe Mëditjet	114,876.84	114,876.84	100.00	81.86	140,339.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	42,600.00	39,399.09	92.49	92.49	42,600.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	8,403.50	8,000.00	95.20	160.00	5,000.00
5	Investime Kapitale	-	-	-	-	-
Totali		165,880.34	162,275.93	97.83	86.35	187,939.00

Administrata dhe Personeli

Tab.4

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	% e reali. alokim	% me buxhet Qert	Buxheti vjetor
1	Pagat dhe Mëditjet	201,743.84	201,743.84	100.00	91.13	221,372.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	142,778.13	133,854.07	93.75	101.31	132,120.00
3	Shpezimet Komunale	1,501.41	128.22	8.54	8.55	1,500.00
4	Subvencione dhe transf.	1,830.00	1,580.00	86.34	158.00	1,000.00
5	Investime Kapitale	77,639.00	53,571.42	69.00	69.57	77,000.00
Totali		425,492.38	390,877.55	91.86	90.27	432,992.00

Drjtorati i Inspektionit

Tab.5

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	% e reali. alokim	% me buxhet Qert	Buxheti vjetor
1	Pagat dhe Mëditjet	58,154.06	58,154.06	100.00	93.14	62,438.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	35,900.00	27,524.99	76.67	76.67	35,900.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-
5	Investime Kapitale	-	-	-	-	-
Totali		94,054.06	85,679.05	91.10	87.13	98,338.00

Zyra e Kuvendit Komunal

Tab.6

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	% e reali. alokim	% me buxhet Qert	Buxheti vjetor
1	Pagat dhe Mëditjet	99,391.15	99,391.15	100.00	91.25	108,920.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	23,100.00	15,087.93	65.32	37.11	23,100.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-
5	Investime Kapitale	-	-	-	-	-
Totali		122,491.15	114,479.08	93.46	86.71	132,020.00

D.për Buxhet dhe Financa

Tab.7

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	% e reali. alokim	% me buxhet Qert	Buxheti vjetor
1	Pagat dhe Mëditjet	89,486.26	89,486.26	100.00	92.22	97,032.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	17,550.00	15,950.82	90.89	90.89	17,550.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-
5	Investime Kapitale	-	-	-	-	-
Totali		107,036.26	105,437.08	98.51	92.02	114,582.00

Sherbimet Publike Emergjente

Tab.8

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	% e reali. alokim	% me buxhet Qert	Buxheti vjetor
1	Pagat dhe Mëditjet	152,360.04	152,360.04	100.00	98.61	154,511.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	256,976.13	252,530.44	98.27	96.18	262,550.00
3	Shpezimet Komunale	52,000.00	51,859.56	99.73	99.73	52,000.00
4	Subvencione dhe transf.	11,795.00	11,637.37	98.66	129.30	9,000.00
5	Investime Kapitale	318,100.88	266,355.59	83.73	90.78	293,406.00
Totali		791,232.05	734,743.00	92.86	95.24	771,467.00

D. Infrastrukturës Publike

Tab.9

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	% e reali. alokim	% me buxhet Qert	Buxheti vjetor
1	Pagat dhe Meditjet	31,709.21	31,709.21	100.00	66.86	47,423.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	22,450.00	20,257.42	90.23	90.23	22,450.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-
5	Investime Kapitale	3,643,880.40	2,946,297.15	80.86	97.22	3,030,683.00
Totali		3,698,039.61	2,998,263.78	81.08	96.70	3,100,556.00

Zyra për Komunitete dhe Kthim

Tab.10

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	% e reali. alokim	% me buxhet Qert	Buxheti vjetor
1	Pagat dhe Meditjet	4,166.82	4,166.82	100.00	52.33	7,963.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	1,036.00	355.11	34.28	34.28	1,036.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-
5	Investime Kapitale	-	-	-	-	-
Totali		5,202.82	4,521.93	86.91	50.25	8,999.00

D.e Bujqësisë

Tab.11

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	% e reali. alokim	% me buxhet Qert	Buxheti vjetor
1	Pagat dhe Meditjet	69,792.75	69,792.75	100.00	106.51	65,530.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	10,700.00	10,586.54	98.94	98.94	10,700.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	58,260.40	56,446.15	96.89	-	50,000.00
5	Investime Kapitale	24,903.97	22,690.85	-	-	-
Totali		163,657.12	159,516.29	97.47	126.37	126,230.00

D.për Planifikim dhe zhvillim Ekonomik

Tab.12

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	% e reali. alokim	% me buxhet Qert	Buxheti vjetor
1	Pagat dhe Meditjet	27,853.08	27,853.08	100.00	42.50	42,906.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	34,300.00	31,880.56	92.95	92.95	34,300.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-
5	Investime Kapitale	-	-	-	-	-
Totali		62,153.08	59,733.64	96.11	77.37	77,206.00

D.Sherbimeve Kadastrale

Tab.13

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	% e reali. alokim	% me buxhet Qert	Buxheti vjetor
1	Pagat dhe Meditjet	73,043.12	73,043.12	100.00	111.47	77,810.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	5,110.00	4,349.49	85.12	85.12	5,110.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-
5	Investime Kapitale	60,759.36	56,879.95	-	-	60,000.00
Totali		138,912.48	134,272.56	96.66	93.95	142,920.00

D.për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të mjedisit

Tab.14

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	% e reali. alokim	% me buxhet Qert	Buxheti vjetor
1	Pagat dhe Meditjet	36,702.43	36,702.43	100.00	56.01	47,199.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	17,450.00	16,597.69	95.12	95.12	17,450.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-
5	Investime Kapitale	82,000.00	80,894.96	98.65	98.65	82,000.00
Totali		136,152.43	134,195.08	98.56	91.51	146,649.00

D.Administratës Shëndetësi

Tab.15

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	% e reali. alokim	% me buxhet Qert	Buxheti vjetor
1	Pagat dhe Meditjet	33,318.25	33,318.25	100.00	50.84	35,778.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	57,740.00	57,470.21	99.53	99.53	57,740.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	34,168.76	27,915.75	-	-	26,347.00
5	Investime Kapitale	-	-	-	-	-
Totali		125,227.01	118,704.21	94.79	99.03	119,865.00

Sherbimet Primare Shëndetësore

Tab.16

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	% e reali. alokim	% me buxhet Qert	Buxheti vjetor
1	Pagat dhe Meditjet	1,243,350.61	1,243,350.61	100.00	102.62	1,211,645.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	212,687.67	193,605.70	91.03	56.47	342,850.00
3	Shpezimet Komunale	44,400.00	44,170.03	99.48	99.48	44,400.00
4	Subvencione dhe transf.		-	-	-	-
5	Investime Kapitale	483,223.90	357,052.25	73.89	100.58	355,000.00
Totali		1,983,662.18	1,838,178.59	92.67	151.71	1,953,895.00

Sherbimet Sociale

Tab.17

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	% e reali. alokim	% me buxhet Qert	Buxheti vjetor
1	Pagat dhe Meditjet	69,714.16	69,714.16	100.00	89.71	77,713.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	15,680.00	15,310.74	97.65	19.70	15,680.00
3	Shpezimet Komunale	5,720.00	5,600.96	97.92	7.21	5,720.00
4	Subvencione dhe transf.		-	-	-	-
5	Investime Kapitale	-	-	-	-	-
Totali		91,114.16	90,625.86	99.46	116.62	99,113.00

D.për Kultur Rinë dhe Sport

Tab.18

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	% e reali. alokim	% me buxhet Qert	Buxheti vjetor
1	Pagat dhe Meditjet	65,741.47	65,741.47	100.00	84.60	66,081.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	47,320.00	40,065.81	84.67	51.56	47,320.00
3	Shpezimet Komunale		-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	60,500.00	60,199.61	99.50	77.46	60,000.00
5	Investime Kapitale	325,948.04	260,748.04	-	335.53	215,000.00
Totali		499,509.51	426,754.93	85.43	109.87	388,401.00

D. Administratës ArsIm

Tab.19

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	% e reali. alokim	% me buxhet Qert	Buxheti vjetor
1	Pagat dhe Meditjet	62,925.63	62,925.63	100.00	80.97	75,833.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	253,956.00	247,436.26	97.43	97.43	253,956.00
3	Shpezimet Komunale		-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	80,243.90	79,700.00	-	102.56	80,000.00
5	Investime Kapitale	623,406.04	486,901.05	-	626.54	492,206.00
Totali		1,020,531.57	876,962.94	85.93	97.22	901,995.00

Arsimi Parafillor

Tab.20

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	% e reali. alokim	% me buxhet Qert	Buxheti vjetor
1	Pagat dhe Meditjet	118,022.00	118,022.00	100.00	100.42	117,525.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	48,919.30	34,690.55	70.91	29.52	44,480.00
3	Shpezimet Komunale	6,000.00	6,000.00	100.00	5.11	6,000.00
4	Subvencione dhe transf.		-	-	-	-
5	Investime Kapitale	-	-	-	-	-
Totali		172,941.30	158,712.55	91.77	135.05	168,005.00

Arsimi Fillor

Tab.21

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	% e reali. alokim	% me buxhet Qert	Buxheti vjetor
1	Pagat dhe Meditjet	4,355,840.55	4,355,840.55	100.00	96.67	4,505,970.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	295,430.33	280,266.63	94.87	101.22	276,894.00
3	Shpezimet Komunale	60,493.00	60,493.00	100.00	100.00	60,493.00
4	Subvencione dhe transf.		-	-	-	-
5	Investime Kapitale	12,773.47	12,572.20	98.42	0.28	6,301.00
Totali		4,724,537.35	4,709,172.38	99.67	96.21	4,849,658.00


Arsimi I Mesem

Tab.22

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	% e reali. alokim	% me buxhet Qert	Buxheti vjetor
1	Pagat dhe Meditjet	1,242,692.94	1,242,692.94	100.00	98.66	1,259,517.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	72,255.00	69,695.12	96.46	96.46	72,255.00
3	Shpezimet Komunale	19,000.00	19,000.00	100.00	100.00	19,000.00
4	Subvencione dhe transf.		-	-	-	-
5	Investime Kapitale	-	-	-	-	-
Totali		1,333,947.94	1,331,388.06	99.81	98.56	1,350,772.00

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet SIMFK-së	shpenzimet 2019	Shpenzimi 2018	% e reali. alokim	% me 18	Buxheti vjetor
1	Pagat dhe Meditjet	8,171,885.21	8,150,885.21	8,088,930.96	99.74	100.77	8,423,505.00
2	Mallrat dhe Shërbimet	1,613,938.59	1,506,915.17	1,269,356.61	93.37	118.71	1,716,041.00
3	Shpenzimet Komunale	189,114.41	187,251.77	150,368.47	99.02	124.53	189,113.00
4	Subvencione dhe transf.	255,201.56	245,478.88	232,616.27	96.19	105.53	231,347.00
5	Investime Kapitale	5,652,635.06	4,543,963.46	4,133,704.84	80.39	109.92	4,611,596.00
Totali		15,882,774.83	14,634,494.49	13,874,977.15	92.14	105.47	15,171,602.00

Tabela e shpenzimit



Në tabelen e lartë shënuar është paraqitur gjendja e mjeteve të alokuara janar - Dhjetor/019 sipas karakterit ekonomik të shpenzimit, planifikimi i shpenzimit dhe shpenzimi. Ndarja e mjeteve nënkupton kërkesa e komunës për t'i pasur mjetet në disponim që t'i zotojë për të krijuar mundësi të porosisë së shërbimit-mallit; ndërsa me planifikim është menduar masa e shpenzimit të mjeteve, pasi të jenë përmbushur kërkesat ligjore të pagesës. Në ndarjen e përgjithshme (15,882,774.83€) Kategorija Ekonomike e Shpenzimeve Kapitale merr pjesë 35.59%, mjete këto të alokuara në disponim për t'i kryer zotimet, para se të lidhen kontratat.

Shfrytëzimi i mjeteve të ndara (15,882,774.83) në këtë vit është realizuar (14,628,358.52) 90.63 %, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (13,874,977.15) kemi rritje të performancës për+ 5.43 %.

Në kategorin mallra dhe shërbime kemi të alokuar më pakë shumën prej :96,378.91 € dhe kjo nga huaja e cila nuk është alokuar në shumën e parapar.

Në kategorin e Subvencioneve dhe Transfereve kemi alokim më shumë për :23,854.56 € dhe atë bartje nga viti i kaluar.

Në kategorin e Investimeve kapitale kemi të alokuar më shumë shumën prej: 1,041,039.06 € dhe atë si rezultat i bartjeve dhe Grantëve të performancës të fituara nga Komuna.

Ndërsa sa i përket dy kontratave kolektive si Sektori i Arsimit dhe ai i Shëndetësisë i kanë kushtuar buxhetit të komunës në vlerë prej : 600,322.78 €, dhe atë nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimet janë marr mjete në shumë prej:261,218.25 €, nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve shuma prej 16,868.61 € dhe nga kategoria e Investimeve Kapitale shuma prej: 322,235.27 €.

Kryetari i Komunës
Bilal Lladrovci




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 462/01-4277 dt. 24.01 2020

DATE/A:	24.01.2020
PËR/ZA/TO:	Asamblistët e Kuvendit të Komunës së Drenasit
NGA/OD/FROM:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit;
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim rreth përfundimit të kontratave për shfrytëzues të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit!



Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Drenasit,

Duke pasur për bazë Ligjin Nr. 06/092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, respektivisht nenin 23 paragrafin 1 dhe 2, ju njoftoj si në vijim:

Komuna e Drenasit gjatë viteve paraprake ka lidhur disa kontrata për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cilave kontrata ju ka skaduar afati i shfrytëzimit, andaj ashtu siç me obligon legjislacioni në fuqi po ju njoftoj me ato prona:

1.Kontrata e lidhur me datë 06/07/2009, me nr. 462-5516, me sipërfaqe 0.03.00 ha e cila është pjesë e ngastrës nr.438, në Zonën Kadastrale në Gllobar.
Shfrytëzues i përkohshëm (10 vite) ka qenë NTP “Besi Comerc” me pronarë Mustafë Morina nga fshati Gllobar.

2.Kontrata e lidhur me datë 10/05/2005, me nr.421-273 me sipërfaqe 0.05.00 ha e cila është pjesë e ngastrës nr.438/3, në Zonën Kadastrale në Gllobar.
Shfrytëzues i përkohshëm (10 vite) ka qenë SHAIPI Morina nga fshati Gllobar.

3.Kontrata e lidhur me datë 06/05/2005, me nr.421-252, me sipërfaqe 0.02.00 ha e cila është pjesë e ngastrës nr.438/4, në Zonën Kadastrale në Gllobar.
Shfrytëzues i përkohshëm (10 vite) ka qenë QSHA “AUTOHOBBY” e përfaqësuar nga drejtori Sabit K. Elshani nga fshati Gllobar.

4.Kontrata e lidhur me datë 06/07/2009, me nr.462-4634, me sipërfaqe 0.40.00 ha e cila është pjesë e ngastrës nr.503, në Zonën Kadastrale në Gllobar.
Shfrytëzues i përkohshëm (10 vite) ka qenë NT. Export Import “Fer Petrol” me pronarë Mehdi Xhoka nga fshati Tërstenik.

5.Kontrata e lidhur me datë 25/03/2009, me nr.463-1955, me sipërfaqe 0.15.00 ha e cila është pjesë e ngastrës nr.150/1, në Zonën Kadastrale në Arllat.
Shfrytëzues i përkohshëm (10 vite) ka qenë Autoshkolla “Albioni” e përfaqësuar nga drejtoresha Filloreta Bujupi nga fshati Arllat.

Duke mos pasur asnjë mundësi të vazhdimit të tyre, sepse një gjë të tillë e ndalon neni 23 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i cili thotë: Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës, në këtë formë duke mos lejuar asnjë vazhdim të asnjë kontrate, pa marr parasysh investimet e bëra nga personat që e kanë pasur në shfrytëzim pronën e paluajtshme komunale.

Sa për informacionin tuaj, në lidhje me këtë çështje i kemi shkruar edhe Ministrinë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ku i kemi kërkuar sqarime se si të veprojmë, e njëjta është përgjigjur se të gjitha pronat e dhëna në shfrytëzim pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratë i kthehen komunës.

Andaj, për pronat e lartcekura propozoj që të njëjtat duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Ligjit Nr. 06/092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, me qellim të përfitimit ekonomik të Komunës sonë, të ipen prapë në shfrytëzim pasi që sipas planit zhvillimor komunale në ato prona nuk është paraprake ndonjë investim nga ana e Komunës.

- Bashkangjitur gjeni kërkesën nga Komuna e Drenasit, si dhe përgjigjen e MAPL-së Nr.463-32, të datës 10.01.2020.

From: Flamur Curri
Sent: 11 December 2019 10:10
To: Besim Murtezani; Xhevat Tafa
Cc: Ramiz Lladrovci; Rozafa Ukimeraj; Nazmi Hasi
Subject: Kërkesë nga Komuna e Drenasit!

Të nderuar,

Po ju shkruaj në lidhje me Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale, i cili ka hyrë në fuqi në Mars të vitit 2019, e gjithë kjo duke pasur parasysh që çdo veprim nga ana e Institucioneve Lokale do të ketë për bazë vlerësimin e ligjshmërisë nga ana juaj, respektivisht MAPL-së, në lidhje me këtë çështje.

Komuna e Drenasit, nder vite ka dhënë në shfrytëzim disa prona të paluajtshme, disa prej të cilave në shfrytëzim afatshkurtër e disa në shfrytëzim afatgjatë.


Kohet e fundit kemi shumë kërkesa për vazhdimin e kontratave nga ana e shfrytëzuesve të pronave të paluajtshme, të cilat i kanë pasur në shfrytëzim afatshkurtër, e të cilëve ju ka skaduar afati i shfrytëzimit, gjithnjë të njëjtit duke u bazuar në kontratat e nënshkuara me Zyrtarin Kryesor Administrativ, në të cilat kontrata është lenë edhe mundësia e vazhimit të tyre. Problemi shfaqet kur kemi parasysh paragrafin 1 të nenit 23 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale, i cili thotë: Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës.

Me mirëkuptim kërkojmë nga ana juaj, nëse është e mundshme ndonjë mundësi e vazhimit të atyre kontratave, (gjithnjë duke u vazhduar prona e dhënë në shfrytëzim përmes Kuvendit) të cilat jo vetëm i kanë përmbushur obligimet kontraktuale por edhe të njëjtat i kanë tejkaluar, p.sh. kemi biznese të cilat e kanë dyfishuar apo trefishuar investimin për të cilin janë zotuar, si dhe e kanë trefishuar numrin e punëtorëve.

Andaj, nëse do të kishim ndonjë alternativ nga ana juaj, duke u bazuar në praktikat e ndryshme, do të ishte e mirëseardhur nga ana jonë, në të kundërtën do të ndodhemi në situata tepër të palakmueshme, duke dëmtuar jashtëzakonisht shumë biznese, të cilët e kanë në shfrytëzim afatshkurtër Pronën Komunale në Komunën e Drenasit, e të cilët kanë bërë investime të mëdha.

Paraprakisht ju falënderoj për gatishmërinë dhe bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,
Flamur Curri
Shef i Kabinetit të Kryetarit
Komuna e Drenasit
Tel; 03820040582
Mob; +38349977877
Email; flamur.curri@rks-gov.net



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 27.12.2019

Për: Flamur Curri, Shef i Kabinetit të Kryetarit, Komuna e Glogocit

Lënda: Përgjigje në kërkesë

I nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar një kërkesë nga ju, lidhur me vazhdimin e kontratave nga ana e shfrytëzuesve të pronave të paluajtshme të cilat i kanë pasur në shfrytëzim afatshkurtër.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, duke u bazuar në vlerësimin e ligjshmërisë sqaron se:

- MAPL, sqaron se Ligji Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale se pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës;
- Kryetari i Komunës, obligohet që ta njoftoj Kuvendin e Komunës pas përfundimit të kontratave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke përshkruar gjendjen aktuale të pronës, si dhe të jap propozimet për destinimin e saj në të ardhmen.

MAPL, është e gatshme të ofrojë përkrahje dhe ndihmën e nevojshme, për zbatimin e plotë të obligimeve që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.

Me respekt,

Adrijana Hodžić,
Ministër e MAPL-së

[Signature]
Kopje: Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glogocit
Labiriot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glogocit
Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së
Arkivit të MAPL-së